Veprimtaria lobiste dhe diplomatike e LPK-së në vitet 1987-1994

Shkruan: Fatmir Lekaj, politolog

Hyrje

Qëllimi im me këtë kumtesë është për të ndriçuar një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë lobiste dhe diplomatike të LPK-së në vitet 1987-1994, që lidhet ngushtë me veprimtarinë e Grupit për Ballkanin të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH-s), i iniciuar dhe i themeluar pas mbledhjes së parë të përgjithshme të LPK-së. Mbledhja e parë e përgjithshme e LPK-së, e mbajtur në korrik të vitit 1987 në Zvicër (nën organizimin e Degës së LPK-së jashtë vendit, në të cilën të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e Degës së LPK-së brenda vendit), shënon fuqizimin dhe konsolidimin e LPK-së jashtë dhe brenda vendit. Në këtë vazhdë, GBKNH shërbeu si sektor lobist dhe i diplomacisë joformale i LPK-së, duke pasur një rol kyç për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit, përkatësisht Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s), Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE-s) etj. Në vijim, në pjesën e parë dhe të dytë të kësaj kumtese, do të përqendrohem në mënyrë koncize në prapavijën e themelimit dhe në veprimtarinë e GBKNH-s. Po ashtu, për hir të korrektësisë (që kjo kumtesë të jetë i bazuar në dokumente dhe jo në hamendësime), do të publikoj edhe disa faksimile të rëndësishme (të integruara në tekst), si dëshmi konkrete që dëshmojnë për ato që përshkruaj në lidhje me GBKNH-n. Pikënisje për këtë kumtesë historiografiko-dokumentuese është ftesa për të dhënë kontributin tim në kuadër të simpozіumit shkencor, me rastin e shënimit të 40-vjetorit të LPK-së, të organizuar nga Shoqëria "Lëvizja", Instituti Albanologjik, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, dhe Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës.



I
Prapavija e themelimit të GBKNH-s

I burgosuri politik gjatë viteve ’80, Nufri Lekaj, (pas lirimit nga burgu në fillimvitin 1987, dhe ngritjes së aktakuzës së dytë ndaj tij për burgosje nga regjimi jugosllav), arriti të arratiset nga Kosova. Me sugjerimin e shokëve të organizuar, emigroi në Norvegji, pasi që asokohe ishte rritur numri i shqiptarëve që kishin emigruar në Norvegji dhe ende në këtë shtet nuk ishte konsoliduar ndonjë veprimtari e organizuar politike e emigracionit shqiptar, e cila përbëhej kryesisht nga emigrantë shqiptarë me kontrata të punës në mes të Jugosllavisë dhe Norvegjisë. Në këtë vazhdë u formua Këshilli Popullor i LPK-së (Dega e LPK-së) në Oslo, në krye me Nufri Lekën, njëherësh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, që si organizatë, fillimisht nga viti 1982, njihet si Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRShJ), pastaj si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e nga viti 1993 njihet si Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).

Në Oslo, Nufri Lekaj, gjatë procesit të azil-kërkimit, njoftohet me Berit Backerin (përkthyese gjatë intervistës për azil), e cila, përveçse ishte studiuese e kulturës shqiptare, që nga vitet ’70 dhe njohëse e spikatur (nga të huajt) e gjendjes shoqëroro-politike në Kosovë dhe Shqipëri, ishte edhe veprimtare e shquar e të drejtave të njeriut në kuadër të Procesit të Helsinkit. Veçanërisht pasi u bë pjesë (në cilësinë e këshilltares dhe bashkëpunëtores) e LPK-së në vitin 1987, u bë aktiviste e pakompromis për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, duke vënë tërë potencialin e vet në këtë drejtim.

Gjatë bisedave në mes të Berit Backerit dhe Nufri Lekajt rezultuan ide të reja që, në fakt, kërkonin qasje serioze. Berit Backeri kishte sugjerimet e saj se si mund të veprohet për dekonstruktimin e mitit të Jugosllavisë si vendi (i cilësuar) më demokratik i Lindjes, që kishte entuziazmuar gjithë Perëndimin. Ky entuziazëm kishte formësuar diskursin se Jugosllavia ballafaqohej kryesisht me kërkesat e nacionalizmit kroat dhe shqiptar, të cilat, si kërkesa nacionaliste, nënkuptonin rrezikun për shkatërrimin e Jugosllavisë. Prandaj shtetet perëndimore, për shkaqe kryesisht gjeopolitike, nuk i shihnin kërkesat e nacionalistëve shqiptarë dhe kroatë si kërkesa të drejta dhe reale. Rrjedhimisht, Berit Backeri, si njohëse e mirë e proceseve politike, sidomos e Procesit të Helsinkit (si proces civil dhe si proces ndërshtetëror në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare), konsideronte se LPK-ja do të duhej ta përqendronte veprimtarinë në kuadër të Procesit të Helsinkit, drejt arritjes së kërkesave të veta për liri dhe barazi**.** Por, sipas saj, këto kërkesa do të duhej të artikuloheshin nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, sepse në këtë mënyrë tërthorazi edhe kërkesa e LPK-së për Republikën e Kosovës gradualisht do të mund të zinte vend si çështje për zgjidhje politike dhe diplomatike në kuadër të kancelarive të shteteve perëndimore, meqë si kërkesë parashihte vetëm avancimin e statusit politik të Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave dhe jo ndryshimin e kufijve ndërshtetëror, dhe rrjedhimisht përveçse kjo kërkesë e LPK-së ishte në përputhje me parimin e Deklaratës së Helsinkit për barazinë e të drejtave dhe vetëvendosjen e popujve, nuk binte drejtpërdrejt ndesh me dy parimet e tjera të Deklaratës së Helsinkit, përkatësisht parimin e paprekshmërisë së kufijve dhe parimin e integritetit territorial të shteteve. Njëherësh, veçanërisht insistonte që të fokusohej kryesisht në çështjen e të drejtave të njeriut, ngaqë Deklarata e Helsinkit ishte e nënshkruar edhe nga Jugosllavia. Një ndër parimet bazë të Deklaratës së Helsinkit ishte respektimi i parimit i të të drejtave të njeriut. Për më tepër, insistonte, duke shpjeguar se në vazhdën e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE-së), e bazuar në Deklaratën e Helsinkit (1975), i njohur si Procesi i Helsinkit, sidomos nga viti 1986, gjatë mbledhjeve të rregullta të KSBE-së në Vjenë, u jepej gjithnjë e më shumë hapësirë grupeve të Helsinkit, përkatësisht komiteteve të Helsinkit si në aspektin e informimit, këshillimit dhe pjesëmarrjes, në lidhje me

çështjet e të drejtave të njeriut dhe gjendjes së minoriteteve kombëtare brenda shteteve. Kështututje këto sugjerime dhe mendime të Berit Backerit, Nufri Lekaj i shqyrtoi me dy eksponentët kryesorë të kohës në LPK, njëri anëtar i kryesisë dhe i angazhuar në riorganizimin e LPK-së (Xhavit Haliti), tjetri anëtar i këshillit të përgjithshëm dhe përgjegjës për kontakte me autoritete dhe organizata të huaja (Ibrahim Kelmendi). Jo për t'i anashkaluar strukturat e organizatës, por duke kërkuar mirëkuptim për ta ruajtur rolin e Berit Backerit në kuadër të organizatës në mënyrë që të mos dekonspirohet veprimtaria e cila ishte në ngritje e sipër, që të dy, Ibrahim Kelmendi dhe Xhavit Haliti, jo vetëm se u pajtuan, por edhe e ndihmuan në çdo aspekt këtë veprimtari, edhe me kontakte të drejtpërdrejta me Berit Backerin, duke bërë edhe koordinimin e duhur.

Rrjedhimisht, në fundvitin 1987 formalizohet projekti i Grupit për Kosovën dhe pa asnjë hamendje u vendos që Grupi për Kosovën të kyçet brenda Komitetit Norvegjez të Helsinkit (KNH-s) për dy arsye kryesore. Njëra arsye ishte se Grupi për Kosovën konsideronte se nëpërmes KNH-s do të mund ta ushtronte ndikimin e vet për Kosovën në kuadër të Procesit Civil të Helsinkit, përkatësisht në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s), duke përfshirë Helsinki Watch Amerikan (nga viti 1988 i njohur si Human Rights Watch) dhe në organizata të tjera ndërkombëtare me ndikim për të Drejtat e Njeriut, si Amnesti Internacional etj. Arsyeja tjetër ishte se Grupi për Kosovën konsideronte se nëpërmes KNH-s do të mund ta ushtronte ndikimin e vet për Kosovën edhe në kuadër të Procesit Ndërshtetëror të Helsinkit, meqë KNH ishte edhe pjesë e rëndësishme këshillëdhënëse për Ministrinë e Jashtme Norvegjeze (MPJN) në fushën e të Drejtave të Njeriut dhe, kështututje, Grupi për Kosovën shpresonte se nëpërmes MPJN do të mund të ndikohej edhe te ministritë e jashtme të shteteve perëndimore, përkatësisht te delegacionet e tyre në kuadër të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE-s).

Berit Backer, me ndihmën e mikut të saj, Kristoffer Gjøtterud, organizoi një takim me Bordin e KNH-s. Në këtë takim ishin të pranishëm Berit Backer dhe Nufri Lekaj, të cilët sqaruan nevojën e përfshirjes së Grupit për Kosovën në KNH (ashtu siç KNH kishte vepruar më herët me Solidarnostin polak), duke e siguruar Bordin e KNH-s, se qëllimi i Grupit për Kosovën kishte të bënte, thjesht, vetëm me veprimtari për të drejtat e njeriut. Këtu qëndronte edhe arsyeja pse nevojitej që qëllimi i plotë i Grupit për Kosovën të ruhej si konspirativ edhe brenda LPK-së, dhe vetëm tre eksponentët e LPK-së e dinin qëllimin e plotë që synonte Grupi për Kosovën. Fillimisht GBKNH u quajt Grupi për Kosovën i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH), por me insistimin e Berit Backerit e vazhdoi veprimtarinë me emrin Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH), në mënyrë që informacioni dhe veprimtaria e këtij sektori të mos paragjykoheshin krejtësisht si veprimtari dhe informacione subjektive për Kosovën, por të jenë sa më të depërtueshme, sa më bindëse dhe sa më të pranueshme për kancelaritë e shteteve perëndimore.

Në kuadër të konsolidimit të veprimtarisë së GBKNH-s, me sugjerimin e Berit Backerit, Nufri Lekaj udhëton në Londër në vitin 1988 ku, përveçse takohet me disa personalitete të kulturës dhe politikës angleze, takohet edhe me Ihsan Toptanin, nga të cilët merr këshilla të vyeshme. Përveç të tjerash, sugjerimet e Ihsan Toptanit kanë qenë që organizatat e shqiptarëve në përpjekjet e tyre për arritjen e lirisë dhe barazisë së shqiptarëve në Jugosllavi, të mos merren me çështjet ideologjike, por të profilohen vetëm si organizata për të drejtën kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi, përkatësisht të mos merren me Enver Hoxhën dhe sistemin politik në Shqipëri. E, në fakt, Enver Hoxha dhe sistemi politik në Shqipëri nuk ishte qëllimi parësor i LPK-së, madje edhe formalisht u hoq dorë nga kjo, pas përmbysjes së sistemit diktatorial në Shqipëri. Dhe ky ishte tregues i qartë se LPK-ja, në esencë, kishte si qëllim parësor çështjen kombëtare mbi çdo ideologji, ashtu siç ishte shprehur një ndër themeluesit e LPK-së, Jusuf Gërvalla, në një intervistë të realizuar para demonstratave të vitit 1981, përkatësisht në vitin 1980, e publikuar më 20 janar 1982 në gazetën

gjermane “Tagische Zeitung”, në njërën nga pyetjet e gazetarit të kësaj gazete, se a do ta kërkonit bashkimin me Shqipërinë, pavarësisht se në Shqipëri mbretëron sistemi radikal komunist, radikal demokratik ose një sistem i së drejtës? Jusuf Gërvalla përgjigjet: Pavarësisht nga çfarëdo sistemi!

Më konkretisht, organizimi i takimit me Ihsan Toptanin ishte në vazhdimësinë e krijimit të kontakteve, respektivisht informimit dhe njohjes së realitetit të situatës së shqiptarëve në Jugosllavi, por dhe njohjes së Ihsan Toptanit me eksponentë të LPK-së, që si organizatë shihej me rezerva nga qarqe të caktuara për shkak të vijës së majtë ideologjike. Si personalitet, Ihsan Toptani, përveçse në të kaluarën e kishte dëshmuar përkushtimin e tij për të ndërmjetësuar mes palëve për të gjetur kompromis për qëllimet kombëtare (në cilësinë e organizatorit për mbarëvajtjen e Konferencës së Mukjes në vitin 1943), në këtë vazhdë, pasi emigroi në Mbretërinë e Bashkuar, është konsideruar në vazhdimësi si personaliteti shqiptar më kredibil edhe për shkak të neutralitetit të tij rreth përplasjeve ideologjike të emigracionit shqiptar nga Shqipëria. Rrjedhimisht, Ihsan Toptani ishte informues kredibil për autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me çështjen shqiptare në përgjithësi. Në këtë kuadër Berit Backeri jorastësisht konsideronte se informacioni për eksponentët e emigracionit politik nga Kosova (të cilët kryesisht ishin rreshtuar në grupime organizative të majta), nuk perceptohej në mënyrë të duhur nga diplomacia perëndimore, për shkak se shpërndahej një dezinformim nga ana e diplomacisë jugosllave në kuptimin se shqiptarët në Jugosllavi jo vetëm se dëshirojnë ta shkatërrojnë shtetin jugosllav, por dëshirojnë ta ndryshojnë edhe rendin shoqëror, duke aluduar se ata janë fanatikë dhe ekstremistë majtistë etj. Prandaj, Berit Backer insistonte se informacioni i drejtpërdrejtë nga një ndër drejtuesit e LPK-së në emigracion do të shërbejë për një perceptim më të duhur, dhe se Ihsan Toptani e të tjerët ishin njerëz të duhur të cilët do mund ta shpinin më tutje këtë informacion dhe perceptim të duhur, sidomos duke e marrë parasysh faktin se në kontekstin e kohës, Mbretëria e Bashkuar konsiderohej shteti më kredibil për të ndarë informacionin me vendet mike perëndimore, njëherësh konsiderohej se Mbretëria e Bashkuar kishte informacionin më të saktë për zhvillimet historiko-politike të shqiptarëve. Në fakt, Berit Backer kishte krijuar shpejt bindjen e duhur për LPK-në, duke u njohur dhe diskutuar me eksponentë të LPK-së (Lekaj, Haliti, Kelmendi etj.), të cilët ajo i konsideronte si të pangarkuar ideologjikisht dhe, thjesht, si patriot shqiptarë të cilët, për shkak se konsideronin se shqiptarët në Jugosllavi duhet gjithmonë të jenë luajalë ndaj shtetit amë Shqipërisë, ishin rreshtuar në një organizatë të majtë në dukje, por jo në esencë, dhe se nuk ishin rob të asaj të majte ideologjike që në shtetet lindore kishte degraduar në totalitarizëm dhe autoritarizëm, dhe se si qëllim kryesor kishin lirinë dhe barazinë e shqiptarëve me popujt e tjerë në Jugosllavi, por që njëkohësisht nuk e kishin braktisur krejtësisht dëshirën irredentiste (bashkimin e territoreve shqiptare në Jugosllavi me shtetin amë Shqipërinë).

Njëkohësisht, gjatë qëndrimit të tij në Londër, Nufri Lekaj angazhohet vullnetarisht dhe bën regjistrimin e disa qindra të burgosurve politikë shqiptarë në regjistrin qendror në Amnesti Internacional në Londër, meqë shpesh kishte vështirësi të regjistroheshin të burgosurit politikë shqiptarë si të “burgosur të ndërgjegjes” për shkak se aktakuzat serbo-jugosllave ishin të bazuara në “veprimtari armiqësore subverzive” dhe Amnesti Internacional i regjistronte këta të burgosur, por nuk i klasifikonte si “të burgosur të ndërgjegjes”. Me punën e tij disamuajshe arrit ta dëshmojë praktikën e “akuzave” serbe dhe të “dënimeve”, ku del në pah se dënimet ishin “politike” e jo “subverzivo-armiqësore”. Kjo ndikoi që mbi 300 të burgosur të kohës nga numri i madh i të burgosurve në listat e Amnesti Internacional të adaptohen si të “burgosur të ndërgjegjes”. Me t’u kthyer nga Londra në vjeshtën e vitit 1988, Nufri Lekaj, së bashku me Berit Backerin, dhe me ndihmën e mikut të Berites, Kristoffer Gjøtterud etj., e shtuan veprimtarinë e GBKNH-s. Në këtë vazhdë Nufri Lekaj bën propozimin që KNH, në një nga pikat e “këshillimit” të politikës së jashtme norvegjeze, të përfshijë propozimin se kërkesa për “Kosovën Republikë është zgjidhja më e mirë e

problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi". Në këtë vazhdë, me lobimin e shoqes së Berit Backerit, Marianne Heiberg, (bashkëshorte e ministrit norvegjez Johan Jørgen Holst), realizohet një takim në mes të Nufri Lekajt, në cilësinë e përfaqësuesit të LPK-së, dhe ministrit Johan Jørgen Holst. Me këtë rast, Nufri Lekaj e njofton hollësisht ministrin Johan Jørgen Holst për situatën e rëndë të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke argumentuar edhe për kërkesën Kosova Republikë, përveç të tjerash, duke i sqaruar se është kërkesë e parashtruar nga LPK-ja si zgjidhje kompromisi nëpërmes mjeteve politike në të mirë të paqes në Ballkan, përkatësisht si një zgjidhje midis Kosovës së okupuar dhe shtypur nga Serbia, dhe preferencës së parë, e cila do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.

Vlen të theksohet se themelimi i një sektori të tillë si GBKNH, në kuadër të një organizate pothuajse gjysmështetërore norvegjeze (KNH-s), nuk ishte aspak projekt i lehtë, sidomos duke e marrë parasysh lidhjen e fortë të miqësisë në mes të shtetit norvegjez dhe ish- Jugosllavisë. Përkatësisht propaganda serbo-jugosllave pas Luftës së Dytë Botërore kishte arritur gradualisht të ketë ndikim të madh në Norvegji, duke e shtrirë këtë ndikim propagandistik edhe në shtetet e tjera nordike. Fillimisht propaganda serbo-jugosllave e kishte arritur suksesin, duke e përdorur si mjet propagandistik historinë e të burgosurve jugosllavë të luftës në Norvegji (gjatë Luftës së Dytë Botërore) në kuptimin se vetëm serbët kanë qenë anti-nazifashistë të devotshëm: nga njëra anë duke i bashkëlidhur nocionet serb-partizan-antinazifashist-jugosllav, nga ana tjetër duke aluduar se popujt e tjerë në Jugosllavi, sidomos shqiptarët dhe kroatët, kanë qenë më shumë bashkëpunëtorë të nazifashistëve sesa kundërshtarë të nazifashistëve. Në bazë të kësaj propagande Serbia e stimulonte miqësinë me Norvegjinë edhe për arsyen se Norvegjia pas Luftës së Dytë Botërore rezultoi si shteti nordik më proaktiv në politikën e jashtme (krahasuar me shtetet e tjera nordike) dhe me shumë ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për shkak të kësaj lidhjeje në mes të Norvegjisë dhe Jugosllavisë, kolegët norvegjezë në kuadër të GBKNH-s, Berit Backer, Kristoffer Gjøtterud etj., e propozuan Nufri Lekën përgjegjës të GBKNH-s, i cili veçse kishte krijuar profil në mediet norvegjeze si shembull i dëshmuar i viktimës së torturës nga regjimi jugosllav, si ish-i burgosur dhe i përndjekur politik. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë kolegët norvegjezë të GBKNH-s nuk mund të akuzoheshin drejtpërdrejt nga diplomacia jugosllave si anti-jugosllavë (dhe të vënin në siklet të madh marrëdhëniet shtetërore norvegjeze-jugosllave), ndërsa përkrahjen e tyre për GBKNH-n e legjitimonin bazuar në njërin ndër parimet e rëndësishme të Deklaratës së Helsinkit, përkatësisht parimin për respektimin e të drejtave të njeriut. Madje edhe Jugosllavia, si një ndër shtetet nënshkruese, obligohej moralisht dhe politikisht ta respektonte Deklaratën e Helsinkit. GBKNH në këtë mënyrë e legjitimoi veprimtarinë për të drejtat e njeriut pro-Kosovës dhe, pavarësisht prej vështirësive dhe pengesave (si rezultat i lidhjes së fortë të miqësisë në mes të shtetit norvegjez dhe Jugosllavisë), GBKNH arriti të ndikojë jashtëzakonisht shumë për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në vitet '80 dhe fillimvitet '90 jo vetëm nëpërmes ndikimit në kuadër të institucioneve politike të shtetit norvegjez por, gjithashtu dhe veçanërisht, nëpërmes ndikimit në kuadër të organizatave ndërkombëtare, përveç të tjerash, Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s), Amnesti Internacional (AI), Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE-s), si një arenë e konferencave ndërkombëtare në mes Lindjes dhe Perëndimit, e bazuar në Deklaratën e Helsinkit (1975), që më vonë, në vitin 1995, u institucionalizua në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) etj.

Rrjedhimisht, themelimi dhe ngritja e GBKNH-s ishte rezultat i bashkëpunimit në mes të Berit Backerit, Nufri Lekës dhe Kristoffer Gjøtterudit, por edhe i mbështetjes nga LPK-ja si organizatë, nëpërmes Ibrahim Kelmendit (bashkëthemelues i LPK-së, në vitin 1982, së bashku me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhosh Gërvallën etj.), dhe nëpërmes Xhavit Halitit (bashkëpërgjegjës

për ngritjen e strukturave të rezistencës së armatosur në Kosovë - UÇK-së, nga mesi i viteve ’80, së bashku me Xhavit Hazirin, Ahmet Haxhiun etj.), duke përfshirë mbështetjen nga veterani i emigracionit politik shqiptar, dr. Ihsan Toptani, personalitet dhe veprimtar me prirje unifikuese në përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi, gjithashtu edhe mbështetjes së tërthortë nga ministri Johan Jørgen Holst dhe bashkëshortja e tij, Marianne Heiberg. Përndryshe, Johan Jørgen Holst ka qenë politolog me përvojë hulumtuese shkencore në Universitetin e Harvardit, dhe ministër i Mbrojtjes dhe ministër i Jashtëm i Norvegjisë gjatë viteve ’80 dhe fillimviteve ’90. Po ashtu, i mirënjohur ndërkombëtarisht në lidhje me ndikimin e tij për arritjen e “Marrëveshjes së Oslos” në mes të Izraelit dhe Palestinës në vitin 1993. Ndërsa Marianne Heiberg ka qenë studiuese e njohur pranë Institutit Norvegjez për Politikë të Jashtme (NUPI), njëherësh tezja e Jens Stoltenbergut (aktualisht sekretar i NATO-s), mike e ngushtë e Berit Backerit, dhe lobiste për takimin joformal në fillimvitin 1989 në mes të përfaqësuesit të LPK-së, Nufri Lekaj, dhe ministrit Johan Jørgen Holst. Në fakt, ministri Johan Jørgen Holst i ka cilësuar Berit Backerin dhe Nufri Lekën këshilltarë të rëndësishëm në lidhje me situatën e shqiptarëve në Ballkan dhe zhvillimet në ish-Jugosllavi. Me fjalë të tjera, me ministrin Johan Jørgen Holst politika e jashtme norvegjeze fillon të ndryshojë, duke u bindur dhe pasur keqardhje për gjendjen e rëndë të të drejtave të njeriut në Kosovë, madje duke treguar deri në një masë kuptueshmëri për domosdoshmërinë e avancimit të statusit politik të Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave. Në këtë vazhdë kjo qasje e politikes së jashtme norvegjeze u sforcua edhe më shumë (sidomos gjatë periudhës së luftës në Kosovë), në krye me udhëheqësin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), njëherësh ministër i Jashtëm i Norvegjisë, Knut Vollebæk, dhe kryeministrin Kjell Magne Bondevik, e kështututje edhe me angazhimin e diplomatit Kai Eide etj.

Në vijim faksimile e dokumentit (listës së emrave dhe adresave) të Grupit për Kosovën në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GKKNH), i themeluar në vitin 1988, më pastaj i quajtur Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH). Në këtë dokument janë të listuar emrat dhe adresat e kryesisë së Grupit për Kosovën, bashkërisht me disa nga anëtarët e udhëheqjes së bordit dhe kryesisë së Komitetit Norvegjez të Helsinkit (KNH-s), të cilët bashkërisht e mbështetën veprimtarinë e GBKNH-s për Kosovën:



Adresse liste for Kosovo-gruppen

Pp

Navn	Adresse	Telefon
Berit Backer	Baldersgt. 1 A 0263 Oslo 2	P.449447 A.530890 F.449579
Kristoffer Gjøtterud	Jacob Aallsgt. 45 A 0364 Oslo 3	P.699715 A.456457 F.456422
Nufri R. Lekaj	Enerhauggt. 3 0651 Oslo 6	P.572977 P. Søker. 096 90022
Tore Lindholm	Institutt for Menneskerettigheter St. Olavsgt. 29 0166 Oslo 1	P.146262 A.111052 F.364801
Pål Haugland	Grev Wedels plass 4 0151 Oslo 1	P.299087 A.335815 F.335819
Svein Mønnesland	Univeritetet i Oslo p.b. 1028 Blindern 0315 Oslo 3	P.461571 A.456351 F.454310
Aleksander Gleichegewicht ********** **********	Stasjonsveien 43 0385 Oslo 3 ********** **********	P.140669 F.570088 ********** **********
Stein-Ivar Aarsæther	Fagerborggt. 40 A N - 0360 Oslo 3	P.606709 A.363500 F.363509 P. Søker 096 76725
Bjørn Cato Funnemark	Ludvig Karstensvei 11 1064 Oslo 10	P.326334 A.570070 F.570088
Jaroslaw Pawlak	Elgtråkket 7 C 2014 Blystadlia	P.326334 A.570070 F.570088

Berit Backer, social-antropologe dhe veprimtare e të drejtave të njeriut.

Kristoffer Gjøtterud, profesor i fizikës në Universitetin e Oslos dhe veprimtar i të drejtave të njeriut.

Nufri R. Lekaj, ish-i burgosur dhe i përndjekur politik. Veprimtar i drejtave të njeriut. Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së. Përgjegjës për GBKNH.

Tore Lindholm, filozof dhe veprimtar i të drejtave të njeriut, njëherësh profesor në Universitetin e Oslos.

Pål Haugland, avokat dhe veprimtar i drejtave të njeriut.

Svein Mønnesland, profesor i gjuhëve sllave në Universitetin e Oslos, njëherësh veprimtar i të drejtave të njeriut.

Aleksander Gleichegewicht, fizikan, disident dhe veprimtar i të drejtave të njeriut, njëherësh veprimtar i Solidarnostit.

Stein Ivar Aarsæther, gazetar dhe veprimtar i të drejtave të njeriut, njëherësh kryetar i Bordit të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Bjørn Cato Funnemark, gazetar dhe veprimtar i të drejtave të njeriut, njëherësh sekretar i përgjithshëm i Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Jaroslaw Pawlak, gazetar dhe veprimtar i drejtave të njeriut, njëherësh veprimtar i Solidarnostit.

Në vijim disa nga mbështetësit - bashkëpunëtorët e tjerë të jashtëm të Grupit për Ballkanin të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH-s) (angazhimi/profesioni aktual i tyre i kohës në Norvegji):

Shkëlzen Kukleci, aktivist i të drejtave të njeriut, simpatizant i LPK-së
Ali Aliu, aktivist i LPK-së
Hajrie Aliu, aktiviste e LPK-së
Isa Thaçi: aktivist i LPK-së
Blerim Rexhepi, aktivist i LPK-së
Jashar Etemaj, aktivist i LPK-së
Afet Ismajli, aktivist i LPK-së
Gëzim Haklaj, deputet i Kuvendit të Kosovës, simpatizant i LPK-së
Rrahim Përçuku, pedagog, simpatizant i LPK-së
Qani Dehari, sipërmarrës, aktivist i LPK-së
Jonuz Emini: sipërmarrës, simpatizant i LPK-së, etj.

***Në vijim fotot (nga periudha e viteve `80 - `90) e themeluesve dhe mbështetësve kryesor të GBKNH-s* :**

Berit Backer

Ihsan Toptani

Kristoffer Gjøtterud

Ibrahim Kelmendi

Nufri Lekaj

Xhavit Haliti

Ministri i jashtëm norvegjez i mirënjohur ndërkombëtarisht, Johan Jørgen Holst, dhe bashkëshortja e tij Marianne Heiberg, studiuese e njohur pranë Institutit Norvegjez për Politikë të Jashtme (NUPI), mike e Berit Backerit, njëherësh tezja e Jens Stoltenbergut (aktualisht Sekretar i NATO-s). Në foto - në një nga takimet e tyre me Yasser Arafat në lidhje me Marrëveshjen Palestinë – Izrael, të vitit 1993, e ashtuquajtura Marrëveshja e Oslos.

II
Veprimtaria e GBKNH-s

Që të jetë më e kapshme dhe më e qartë veprimtaria e GBKNH-s, për Kosovën në kuadër të Procesit të Helsinkit, fillimisht është e domosdoshme të shtjellohet shkurtimisht rëndësia e Procesit të Helsinkit në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Pikënisje për Procesin e Helsinkit ishte Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE), në kuptimin e një arene të konferencave ndërkombëtare në mes të Lindjes dhe Perëndimit, e bazuar në Deklaratën e Helsinkit (1975). Në fakt, si ide u iniciua në vitin 1954 nga Bashkimi Sovjetik, përkatësisht nga ministri i Jashtëm Vjatsjeslav Molotov, i cili lansoi propozimin për një konferencë të sigurisë në mes të Lindjes dhe Perëndimit, ku parashihej që ShBA-ja të ketë vetëm një status të observatores. Ky propozim u refuzua nga Perëndimi, madje shtetet e fuqishme perëndimore e cilësuan këtë propozim si një tentim të Bashkimit Sovjetik për ta parandaluar/penguar riarmatimin në Gjermaninë Perëndimore dhe t'i dobësojë marrëdhëniet në mes të Evropës dhe ShBA-së.[1] Po ashtu, Leonid Bresjnev, gjatë Kongresit të partisë në vitin 1966, u bëri thirrje shteteve evropiane për t'i trajtuar dhe zgjedhur bashkërisht çështjet e sigurisë politiko-ushtarake.[2] Kështututje, kjo çështje u trajtua më shumë edhe nëpërmes Deklaratës së Bukureshtit të vitit 1966, Apelit të Budapestit të vitit 1969 etj., ku u përfshinë temat konkrete se me çfarë do të mund të merrej një konferencë e tillë.[3] Në këtë vazhdë shtetet perëndimore evropiane ishin më të hapura për një konferencë të mundshme të sigurisë. Ndërsa presidenti amerikan Richard Nixon dhe ministri i Jashtëm Henry Kissinger ishin skeptikë ndaj iniciativës së Bashkimit Sovjetik, sepse konsideronin se pozicioni udhëheqës i ShBA-së në NATO dhe në bisedimet bilaterale me Bashkimin Sovjetik mund të dobësohej po qe se ShBA-ja bëhej pjesë e një dialogu multilateral për çështjet e sigurisë politiko-ushtarake.[4] Pas shumë peripecive dhe iniciativave, u miratua Deklarata e Helsinkit gjatë Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE) në Helsinki të Finlandës në vitin 1975. Kjo u bë e mundshme, përveç të tjerash, pasi që u arrit që ShBA-ja dhe Kanadaja ta kenë statusin e pjesëtarit të barabartë me shtetet evropiane në kuadër të KSBE-së. Në fakt, kjo nënkupton bumerangun e parë ndaj Bashkimit Sovjetik nga Shtetet Perëndimore ngaqë plani paraprak i Bashkimit Sovjetik ishte që ShBA-ja të ketë vetëm një status të observatores. Megjithëkëtë, Bashkimi Sovjetik, duke e pasur si agjendë pengimin e bashkimit të gjermanëve, insistoi që edhe nëpërmes Procesit të Helsinkit të sigurohen kufijtë shtetërorë të pas Luftës së Dytë Botërore, njëherësh e arriti pajtueshmërinë e të tjerëve që edhe Gjermania Lindore ta ketë statusin e pjesëtares së barabartë në kuadër të KSBE-s. Deklarata e Helsinkit që, përveç Shqipërisë, u nënshkrua nga të gjitha shtetet evropiane, ShBA-ja dhe Kanadaja, nuk ishte juridikisht e detyrueshme, por duke e marrë parasysh se pas shumë peripecive ishte një rezultat i suksesshëm i një konsensusi, kryesisht mes dy superfuqive të kohës (ShBA-së dhe Bashkimit Sovjetik), konsiderohej politikisht dhe moralisht e detyrueshme.

Vlen të theksohet se KSBE u shpërfaq strukturalisht ndryshe krahasuar me Këshillin e Evropës (KE) dhe Kombet e Bashkuara (KB). Një ndër arsyet kryesore për këtë ishte se KSBE u zhvillua si

---

[1] Leif Mevik: *Underveis Europa. Aventura Forlag*, Oslo, 1990, f. 31.

[2] John Fry: *The Helsinki Process. Negotiating Security and Cooperation in Europe*. University Press of Pacific. Hawai, 2003, f. 4.

[3] John Freeman: *Security and the CSCE Process. The Stockholm Conference and Beyond.* Macmillan Basingstoke (London), 1991, f. 39-41, 46.

[4] Daniel C. Thomas: *The Helsinki Effect. International norms, human rights, and the demise of communism,* Princeton University Press, New Jersey, 2001, f. 36.

një proces i vazhdueshëm dhe arenë e dialogut ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit përmes takimeve vijuese të shteteve pjesëmarrëse dhe takimeve të ekspertëve, i njohur si Procesi i Helsinkit. Në periudhën deri në vitin 1989 mbledhjet e KSBE-s (me takimet pasuese) u mbajtën në Beograd (1976-'77), Madrid (1980-'83) dhe në Vjenë (1986-'89). Në vazhdimësi, në kuadër të Procesit të Helsinkit, kritika kryesore e shteteve perëndimore ndaj shteteve të lindjes ishte në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut.[5] Dhe, edhe pse autoritetet sovjetike vazhduan ta shtypnin popullsinë dhe situata mund të dukej e pashpresë për veprimtarët e drejtave të njeriut, megjithëkëtë roli i OJQ-ve (Grupeve të Helsinkit) u bë gradualisht qendror në zhvillimin e Procesit të Helsinkit.[6] Në fakt, kur filloi Konferenca e Vjenës në vitin 1986, Andrei Sakharov ishte ende në "ekzilin e brendshëm" dhe shumica e aktivistëve të të drejtave të njeriut në Bashkimin Sovjetik ose u internuan ose u persekutuan nëpërmes metodave të tjera shtetërore.[7] Anatoly Marchenko, disident dhe një nga themeluesit e Grupit të Helsinkit të Moskës, arriti fshehurazi t'u dërgojë një apel delegacioneve të KSBE-s në takimin e Vjenës, në të cilin apel ai kërkoi mbështetje për t'u përmirësuar kushtet e dënimit në Bashkimin Sovjetik. Ndër të tjera, nëpërmes apelit, ai kërkonte ushqim më shpesh se çdo të dytën ditë. Marchenko vdiq në burg më 6 dhjetor 1986, pas 20 vjetësh burgim. Vdekja u shënua me një minutë heshtje e iniciuar nga kreu i delegacionit amerikan të KSBE-s, Warren Zimmermann, që rezultoi me largimin e delegacionit sovjetik të KSBE-s nga takimi, së bashku me delegacionin nga Bullgaria, nga Gjermania Lindore dhe nga Çekosllovakia. Ndërsa delegacioni nga Hungaria nuk veproi njëjtë në këtë takim, gjë që simbolizon edhe plasjen e parë të kohezionit të Traktatit të Varshavës.[8] Të njëjtin vit (1986), me presionin e Perëndimit, u lirua Andrei Sakharov dhe, në këtë vazhdë, gjatë procesit të mbledhjeve të rregullta të KSBE-s, në Vjenë, në vitet 1986-'89, u vendosën edhe parimet e KSBE-s për pjesëmarrje në proces të organizatave joqeveritare (Grupeve e Helsinkit).

Me fjalë të tjera, në mesin e 10 parimeve të Deklaratës së Helsinkit, ishte i përfshirë edhe parimi për të drejtat e njeriut, dhe gjatë gjithë Procesit të Helsinkit (nga viti 1975) ndikoi për inkurajimin dhe angazhimin e veprimtarisë vullnetare ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti nëpërmes etablimit të Grupeve të Helsinkit të mirënjohur më pastaj ndërkombëtarisht si Komitetet e Helsinkit, në kuadër të të ashtuquajturit Procesi Civil i Helsinkit, i cilësuar edhe si Lëvizja e Helsinkit. Në këtë mënyrë, në kuadër të Procesit të Helsinkit, rezultoi një bumerang i dytë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shteteve të tjera totalitare dhe autoritare, ngaqë grupi i parë i Helsinkit, i njohur edhe si Moscow Helsinki Watch Group, u themelua në Moskë, në banesën e Andrej Sakharovit në vitin 1976, me qëllim që ta monitorojë respektimin dhe implementimin e parimit të Deklaratës së Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Kjo ndikoi që të njëjtin vit të themelohen dy Grupe të Helsinkit në Lituani dhe Ukrainë. Gjithashtu, të njëjtin vit në Poloni u formua Komiteti për Mbrojtjen e Punëtorëve (KOR) dhe në vitin 1977 Lëvizja për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe të Drejtave Qytetare (ROPCiO). Ky komitet dhe kjo lëvizje në Poloni gradualisht rezultuan në aleancën në mes të punëtorëve, intelektualëve dhe kishës dhe themeluan Solidarnostin në vitin 1980 dhe Komitetin Polak të Helsinkit në vitin 1982. Gjithashtu, në vitin 1977 u themelua

---

[5] Anne Elin Kleva: *Konferansen om sikkerhet og samarbeid i Europa 1975-1989. Øst versus Vest: Konferansediplomati om menneskerettighetene. Norge i grenselandet mellom realpolitikk og idealisme.* Mr-oppgave i historie, Oslo 2007, f. 66

[6] Maria Raquel Freire: *Conflict and Security in the Former Soviet Union. The Role of the OSCE*, Ashgate Publishing Limited, Hants 2003, f. 71-72.

[7] http://snl.no/Andrej_Dmitrijevitsj_Sakharov.

[8] C. Van Esterik dhe H. Minnema, "The Conference that came in from the Cold", i *The Human Dimension of the Helsinki Process, the Vienna Follow-up Meeting and its Aftermath,* red. A. Bloed and P. Van Dijk, Martinus Nijhoff Publishers, Nederland 1991, f. 2-7.

Charta 77 në Çekosllovaki, në krye me Vaclav Havelin etj., të cilët kishin krijuar kontakte me strukturat e KSBE-s. Autoritetet shtetërore sovjetike, çekosllovake dhe polake iu përgjigjën me represion aktivistëve për të drejtat e njeriut. Në veçanti autoritetet shtetërore sovjetike iu përgjigjën me represion të ashpër pjesëtarëve të Grupit të Helsinkit në Moskë, me arrestime, burgosje dhe internime të brendshme. Kjo shkaktoi indinjatë të thellë te shtetet anëtare të KSBE-së dhe rezultoi edhe me themelimin e Grupeve të Helsinkit në shtetet perëndimore, që si qëllim parësor kishin mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shtetet lindore. Me këtë qëllim, në vitin 1978, u formalizua themelimi i Grupit të Helsinkit në ShBA, i njohur si Helsinki Watch Amerikan, (e nga viti 1988 i njohur si Human Rights Watch) dhe, për shkak të reputacionit si informator i mirë në lidhje me çështjen e të drejtave të njeriut, e ka pasur në vazhdimësi një ndikim të rëndësishëm këshillues në politikën e jashtme amerikane (delegacionet amerikane të KSBE-s) në kuadër të Procesit të Helsinkit. Gjithashtu, në kontekstin evropian, Grupi i Helsinkit në Norvegji, i njohur si Komiteti Norvegjez i Helsinkit, u themelua shumë herët, përkatësisht në vitin 1977. Në këtë vazhdë, Komitetet e Helsinkit në Shtetet Perëndimore, në kuadër të Procesit Civil të Helsinkit, e themeluan Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit në vitin 1982, me qëllimin, përveç qëllimeve të tjera, të forcohet dhe bashkërendohet edhe më shumë veprimtaria ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të inkurajohen forcat opozitare në Lindje. Gjithashtu, politika reformiste e Mikhail Gorbatsjovit ka qenë vendimtare që sistemet totalitare dhe autoritare të fillojnë të hapen ndaj parimit të Deklaratës së Helsinkit për të drejtat e njeriut.

Vonesa e themelimit të Grupit të Helsinkit (Komitetit të Helsinkit) në Finlandë (1985) është e kuptueshme , e lidhur me linjën përgjithësisht të kujdesshme të politikës së jashtme finlandeze ndaj Bashkimit Sovjetik. Por, çuditërisht, edhe në Suedi dhe Danimarkë, Grupet e Helsinkit (Komitetet e Helsinkit) u themeluan më vonë, përkatësisht në vitin 1982 dhe 1985. Ndërsa themelimi i Komitetit Norvegjez të Helsinkit që në vitin 1977 nuk mund të shpjegohet ndryshe përpos si një ndër indikatorët e rëndësishëm të politikës së jashtme proaktive norvegjeze në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare. Njëherësh kjo shpjegon lidhjen e fortë në mes të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Helsinki Watch American (nga viti 1988 i njohur si Human Rights Watch), Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe strukturave të caktuara në kuadër të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE-s). Gjithashtu, kjo shpjegon pse Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH) ka arritur të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të Procesit të Helsinkit.

Rrjedhimisht, LPK, nëpërmes GBKNH-s, si sektor në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, nga viti 1988, dhe nga viti 1990 si sektor me status zyrtar në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (njëherësh si veprimtari integrale në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit), përveçse fillimisht e arriti kuptueshmërinë e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, se kërkesa "Kosova Republikë është zgjidhja më e mirë e problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi", në periudhën e viteve 1988-1994, inicioi, sugjeroi dhe kontribuoi si në aspektin e informimit, po ashtu edhe në aspektin e mbledhjes së fakteve dhe këshillimit: që fokusi i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s) dhe i strukturave të caktuara në kuadër të KSBE-s të jetë sa më shumë i orientuar kah shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Në fakt, raportet, me informatat dhe këshillat në lidhje me situatën në Kosovë, që përpiloheshin nga anëtarët e kryesisë së GBKNH-s, kur iu dërgonin shtetarëve në shtetet perëndimore dhe delegacioneve të tyre në kuadër KSBE-s, nëpërmes Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s), duke e përfshirë Helsinki Watch Amerikan (Human Rights Watch), e kishin peshën e vet të padiskutueshme si në aspektin e besueshmërisë, si në aspektin e të kuptuarit më objektiv të situatës politike në Kosovë dhe si në aspektin e prishjes së imazhit të serbo-Jugosllavisë.

Në vitin 1988, me instruksionet dhe këshillat e Berit Backerit dhe Nufri Lekës (dhe me ndihmën e bashkëfamiljarëve të Nufriut në Kosovë), ka udhëtuar dhe është pritur në mënyrë të fshehtë në Kosovë, gazetarja dhe politologjia norvegjeze Gro Holm. Gjatë qëndrimit në Kosovë ajo ka mbledhur informata në lidhje me përpilimin e një raporti për gjendjen e jashtëzakonshme sociopolitike në Kosovë. Vlen të përmendet se Gro Holm është bashkëshortja e Kai Eides që ka vlerësuar standardet për Kosovën pranë OKB-së, 17 vjet më pas, dhe në kuadër të propozimeve të tij pranë OKB-së, ka hapur rrugën për zgjidhjen e statusit të Kosovës në drejtimin e pavarësimit të Kosovës.

Për më tepër, vlen të theksohet se GBKNH ka iniciuar, (para shembjes së murit të Berlinit), veçanërisht me ndihmën e Berit Backerit dhe Kristoffer Gjøtterudit ka arritur ta bindë Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan (Human Rights Watch), që një delegacion i përbashkët i specialistëve në fushën e të drejtave të njeriut të udhëtojë me misionin për ta vëzhguar situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Duke insistuar se te shtetet perëndimore ishte një përshtypje e gabuar për Jugosllavinë, që e dallonin "si më e mira ndër më të këqijat" krahasuar me shtetet e tjera autoritare dhe totalitare në Evropën Lindore kur ishin në pyetje të drejtat e njeriut, në veçanti kur ishin në pyetje të drejtat e njeriut në Kosovë. Rrjedhimisht, një delegacion i përbashkët i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan (Human Rights Watch), i drejtuar nga Berit Backer dhe Kristoffer Gjøtterud, udhëtoi në Kosovë në shtator 1989 (para shembjes së murit të Berlinit), ndërsa në janar të 1990-s botohet raporti i parë për situatën në Kosovë nga ky delegacion i përbashkët i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch Amerikan, përkatësisht nga autori Kenneth Andersson, me titull "…Crisis in Kosovo". Në vazhdën e këtij misioni, GBKNH inkurajoi dhe mbështeti themelimin dhe veprimtarinë e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë (KMDLNJ) dhe të Komitetit të Helsinkit në Kosovë nëpërmes bashkëpunimit konkret në mes të Berit Backerit dhe Gazmend Pulës. Ky komitet u themelua në muajin prill 1990 në krye me Gazmend Pulën (kryetar), Ekrem Beqirin (nënkryetar), Agni Dikën (sekretar) dhe anëtarët: Shkëlzen Maliqi, Veton Surroi, Arbër Xhaferi, Drita Mekuli, Muhamedin Kullashi etj. Ndërsa KMDLNJ u themelua në fundvitin 1989 (ku anëtar themelues ishte edhe Gazmend Pula) dhe u udhëhoq, fillimisht nga Bajram Kelmendi, Zekeria Cana, Zenun Qelaj etj. Më pastaj u shtua veprimtaria e këtij këshilli nën udhëheqjen e simbolit të rezistencës kombëtare dhe të drejtave të njeriut, Adem Demaçi, i cili u lirua nga burgu më 21 prill 1990. Në këtë vazhdë, Adem Demaçi lidhi bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësin e GBKNH-s, Nufri Lekën. Gjithashtu, që nga takimi i tij i parë personal në Norvegji me Berit Backerin, rezultoi një respekt i ndërsjellë në mes tyre, veçanërisht një bashkëpunim substancial në veprimtarinë e tyre për të drejtat e njeriut. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, që shërbente si një bazë e fortë "për njohjen e realitetit në Kosovë" nga ana e diplomacisë perëndimore, e kishte peshën e vet të rëndësishme sepse udhëhiqej nga simboli i rezistencës së shqiptarëve për liri dhe barazi, Adem Demaçi, ndërsa Berit Backeri me diturinë dhe nëpërmes kontakteve të saj kudo në Evropë, ndikoi që ky "realitet" të shpërndahet më thellë në strukturat e pushtetit të shteteve perëndimore. Kjo pati ndikimin e vet të rëndësishëm edhe për kyçjen e drejtpërdrejtë dhe veçanërisht për promovimin e meritueshëm të Adem Demaçit në kuadër të Procesit të Helsinkit, si simbol i të drejtave të njeriut, që rezultoi edhe me mirënjohjen e tij me çmimin Sakharov (1991), në këtë vazhdë me mirënjohje të tjera, duke përfshirë çmimin Leo Eitinger (1995). Me të drejtë Adem Demaçi e quante Beriten, Merita, dhe porosiste që të gjithë shqiptarët ta quajnë me këtë emër, siç zakonisht e thërriste Baca Adem: Merita e shqiptarëve.

Shih në vijim faksimilen, përkatësisht fotografinë e kopertinës së raportit të pjesëtarëve të delegacionit të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (përfshirë pjesëtarët e Helsinki Watch

Amerikan dhe të Komitetit Norvegjez të Helsinkit), me një pjesë të falënderimit për Berit Backerin dhe Kristoffer Gjøtterudin etj., në hyrje të këtij raporti (acknowledgements). Po ashtu, shih faksimilen tjetër në vijim si një ndër dëshmitë se GBKNH në vazhdimësi mbështeti KMDLNJ :



Yugoslavia, Crisis in Kosovo

Human rights documents: General

Book 5

Kenneth Anderson Jan 1990

Human Rights Watch

Acknowledgements

This report was written by Kenneth Anderson following a mission (the "mission") to Kosovo and other regions of Yugoslavia in September1989. The mission was a joint mission of the U.S. Helsinki Watch, New York City, and the International Helsinki Federation for Human Rights (the "IHF"), Vienna. Members of the mission were Kenneth Anderson, a member of the U.S. Helsinki Watch Committee and an attorney in private practice in New York; Berit Backer, a Norwegian anthropologist with field experience in Kosovo and knowledge of the Albanian language; Kristoffer Gjotterud, a physicist of the University of Oslo, Norway, and a member of the Norwegian Helsinki Committee; Hester Minnema, Program Director of the IHF in Vienna, Austria; and

KMDLNJ

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë

Council for the Defence of Human Rights and Freedoms in Prishtina

adresa: Xhavit Mitrovica nr 15 38000 Prishtinë-Kosovë tel/fax. 1 38-38-30409

KOMITETIT TË HELSINKUT, Oslo
fax: 9947 22570088

Prishtinë, 6 maj 1993

Të dashur Miq,

Letrën Tuaj të dërguar më 1.05.1993, të nënshkruar nga zoti Nufri Lekaj në lidhje me kërkesën tuaj për lëshimin e një deshmie nga ana e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, për të hollat në shumë prej 10.000 $ US (dhjetëmijë dollarë amerikanë), të cilat i ka dorëzuar z. Tomas Wacko në muajin prill të vitit 1992, ne Ju njoftojmë me sa vijon:

Në prill të vitit 1992, z. Tomas Wacko i dorëzoi z. Zenun Çelaj, sekretar i Këshillit tonë një shumë të hollash prej 17.000 DM (shtatëmbëdhjetëmijë marka gjermane), të dedikuara për të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë.

Të hollat e përmendura janë shpërndarë gjatë vitit të kaluar, për çka është njoftuar edhe zonj. Guri Rusten me rastin e vizitës në Kosovë, në fillim të këtij viti.

Ne posedojmë me listën e njerëzve të cilëve u janë shpërndarë këto ndihma, të cilën me kërkesën Tuaj mund t'ua dërgojmë në çdo kohë.

Njëherit, Miq të dashur, Ju lutemi T'i pranoni përshëndetjet tona të përzemërta për kujdesin Tuaj ndaj personave të cilët, më shumë se ndihmë materiale këtë e konsiderojnë si përkrahje morale. Ju lusim miqësisht që t'ua përcillni përshëndetjet dhe falënderimet tona të gjithë atyre që kanë marrë mundimin të ndihmojnë njerëzit në nevojë.

Me përshëndetje
Në emër të Këshillit
Sami Kurteshi
Sami Kurteshi

Gjithashtu vlen të theksohet se në vazhdën e zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë pas shembjes së murit të Berlinit, GBKNH (duke marrë parasysh se një ndër pikat kyçe të veprimtarisë në kuadër të Procesit të Helsinkit ishte inkurajimi dhe promovimi i forcave opozitare nën regjimet shtypëse), menjëherë pas themelimit të LDK-së e organizoi vizitën e parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14-18 shkurt 1990. Delegacioni ishte në përbërje nga Ibrahim Rugova, kryetar i partisë Lidhja Demokratike e Kosovës, Shkëlzen Maliqi, kryetar i partisë Social-Demokrate të Kosovës, dhe Nufri Lekaj në cilësinë e përfaqësuesit të Lëvizjes Popullore të Kosovës, të cilët u takuan me disa personalitete të rëndësishme shtetërore dhe kulturore norvegjeze. Në vazhdën e kësaj vizite të delegacionit të Kosovës në Oslo dhe me nisje nga Oslo, GBKNH, nëpërmes kontakteve që kishte Berit Backer, Kristoffer Gjøtterud etj., ka lobuar që t'i hapen dyert udhëheqësit të lëvizjes paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugovës, nga politikanët perëndimorë, me qëllim të faktorizimit të Kosovës në bashkëveprimin ndërkombëtar. Vlen të përmendet se Kristoffer Gjøtterud ka qenë një shkencëtar i mirënjohur norvegjez në lëmin e fizikës bërthamore-nukleare, njëkohësisht i interesuar për epistemologjinë dhe metafizikën, në kuptimin e ndërlidhjes në mes të besimit, fesë dhe shkencës etj., së këndejmi ashtu veprimtar i mirënjohur ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në kuadër të Procesit të Helsinkit. Me fjalë të tjera, një personalitet shumë i nderuar dhe me ndikim, përveç të tjerash, kryetar i Komitetit për Hebrenjtë e Bashkimit Sovjetik, që nga viti 1982 (veçanërisht i përkushtuar për shkencëtarët hebrenj, të cilëve iu vështirësohej dhe ndalohej udhëtimi jashtë Bashkimit Sovjetik). Gjithashtu, ka qenë bashkëpunëtor i Grupit të Helsinkit të Moskës (Moscow Helsinki Group), i themeluar në vitin 1976, nga veprimtarët e mirënjohur rusë për të drejtat e njeriut, përkatësisht fizikani dhe nobelisti Andrej Sakharov, historiania Ljudmila Aleksejeva, fizikani Jurij Orlov etj. Rrjedhimisht, Kristoffer Gjøtterud, me këtë prapavijë dhe ndikimin që kishte në kuadër të Procesit të Helsinkit etj., e ka dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për Kosovën, sidomos si pjesë e udhëheqjes dhe si veprimtarë i GBKNH-s. Gjithashtu, vlen të përmendet se gjatë një takimi/tubimi të hapur në Komitetin Norvegjez të Helsinkit më 17.02.1990 (ku edhe tekstshkruesi i kësaj kumtese ishte i pranishëm), Ibrahim Rugova gjatë fjalimit të tij shprehi publikisht konsideratën e tij më të lartë për Kristoffer Gjøtterud.

Në vijim, një faksimile/dokument që dëshmon se GBKNH, në kuadër të veprimtarisë së vet, përveç të tjerash, e organizoi edhe vizitën e parë zyrtare të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Perëndim, më 14-18 shkurt 1990, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo:

FROM 47 2 170753 '90.02.14 12:33

MR.MR. RUGOVA'S AND MALIQI'S VISIT IN OSLO
14 - 18.2.90

WENSDAY, 14.2.90

15.20 - ARRIVAL TO OSLO
16.30 - INTERVIEV IN THE NORWEGIAN RADIO
19.00 - MEETING WITN PEN-CLUB IN NOBEL INSTITUTE, DINNER

THURSDAY, 15.2.90

9.00 - MEETING IN STATE OFFICE FOR FOR ALIENS
11.15 - LECTURE AT OSLO UNIVERSITY (INST. FOR SLAVIC AND BALTIC LANGUAGES)
13.30 - LUNCH IN PRESS-CENTER
13.45 - INTERVIEV FOR NORWEGIAN TV
14.00 - PRESS - CONFERANCE
15.00 - EVENT. INTERVIEVS
19.30 - DINNER (INV. BY KRISTOFFER GJØTTERUD AND MICHAELA SPANDOW)

FRIDAY, 16.2.90
9.30 - SEMINAR IN NORWEGIAN INST. OF FOREIGN AFFAIRS
14.00 - MEETING IN MINISTERY OF JUSTICE (RUGOVA)
16.00 - MEETING IN FOREIGN OFFICE (MALIQI) MALIQI
~~17.00~~ - MEETING WITH REIULF STEEN FROM SOC.DEM. (~~RUGOVA~~)
18.00 - MEETING WITH NORWEGIAN ADVOCATS (~~MALIQI~~)
19.30 - MEETING WITH WRITERS, DINNER (INV. BY TORIL BREKKE)

SUTERDAY, 17.2.90
11.00 - DISSCUSION "WHAT CAN BE DONE IN NORWAY FOR KOSOVO"
13.00 - OPEN MEETING IN NORW. HELSINKI COMM.
19.30 - MEETING WITH NORWEGIAN "VIP" (I = INTERWSTING),DURING DINNER (INV.BY BERIT BACKER)
SUNDAY, 18.2.90

SIGHTSEEING, DISSCUSIONS, LUNCH

17.00 - FLY TO STOCKHOLM

Në vazhdën e zhvillimit të ngjarjeve në Kosovë në vitin 1990, GBKNH organizoi vizitën me nisje nga Oslo të delegacionit të Kuvendit të Kosovës pas shpalljes së Deklaratës për Pavarësinë e Kosovës (Muharrem Shabani, Bujar Gjyrgjeala, Skënder Skënderi). Para dhe pas kësaj vizite, GBKNH, loboi/komunikoi me korrespondencë të ndërsjellë me Parlamentin Evropian etj., duke kërkuar mbështetjen për delegatët e Kuvendit të Kosovës. Si dëshmi për këtë, shih në vijim një foto dhe dy faksimile/dokumente:

Foto (1990), përveç delegatëve të Kuvendit të Kosovës (Muharrem Shabani, Bujar Gjurgjeala dhe Skënder Skënderi), janë Berit Backer, Nufri Lekaj, Qani Dehari, Fadil Demiri, Musa Ramadani, Hasan Ramadani dhe Xhemadin Neziri.



Berit Backer
Balderegt. 1a
0263 Oslo 2
Norway
Phone:(47 2)44 94 47
Fax: (47 2) 44 95 79

To:
The European Parliament
Brussels Headquarters
Rue Belliard 97-113
B-1040 Brussels
Belgium

Oslo June 26, 1990

Re: The parliamentary situation in Kosovo

The following statement has been transferred to me from the undersigned delegates of the People's Assembly of Kosovo with the request to translate it and send it on to the European Parliament.

As can be read it contains a request to the European Parliament for sending observers to the session of the Kosovo People's Assembly at July 2, 1990. The former session was suspended and the chairman of the assembly refused to put on the agenda a proposal for an initiative to draft a new constitution for Kosovo. The delegates question whether the change of the constitution made in June 1989 was lawful, as it was done while there was an emergency situation.

The undersigned is a social anthropologist who happened to meet several Albanian intellectuals from Kosovo at a meeting in Ljubiana on June 22 and 23 at which time the suspension of the Assembly's procedures took place. These intellectuals were very worried about the situation, and I share their concern.

Therefor I implore you to take this request seriously and react in some way. It is very important that the legal bodies of Kosovo can work in peace and according to the laws and regulation, otherwise the situation might deteriorate and serious confrontations might occur, more grave than experienced until now.

Please excuse this rather untraditional approach. It is the situation in the Kosovo People's Assembly and the limited time at disposal that causes these procedures. Otherwise the contact person among the undersigned delegates is Muharrem Shabani, who may perhaps be reached through the People's Assembly. His phone and address will be forwarded later.

Yours sincerely

Berit Backer

Berit Backer



DEN NORSKE HELSINGFORSKOMITE
Urtegt. 50
0187 Oslo 1, Norway
Phone: 47 2-570070 Fax: 47 2-570088

The Ministry of Foreign Affairs
East European Section
Att: Mr. Charles Grey - Deputy Head
Fax. 4471-2702152

Oslo July 17, 1990

RE. VISIT OF KOSOVO PARLIAMENTARIANS

Dear Mr. Charles Grey,

Thank You for Your kind resons to our request for the Kosovo parliamentarians, Mr. Shabani, Mr. Skenderi and Mr. Gjergjeala to visit the Ministry of Foreign affairs (see enclosed description). The date July 30th, and 31st if necessary, has been reserved for London, and we would suggest for them to see Your section on the morning of the 30th. Hopefully that is suitable for you.

They shall also meet members of human rights organizations as well as members of parliament and the press.

They are much concerned about presenting the problems Kosovo as they have developed lately. Our concern is the importance for this conflict to be chanalized through suitable democratic channels, so that more serious confrontations than have been seen so far will not develop. The development of the human rights situation in Kosovo at present, is worrying.

As you are well informed about the genereal development, we assume that there is no need for further bakcground material. The parliamentarians will bring documentation on recent violations of human rights in Kosovo.

Please respond to the above listed fax number.

Yours sincerely
For the Norwegian Helsinki Committee

Berit Backer

GBKNH mbështeti edhe veprimtarinë e sindikatave të Kosovës, në krye me Hajrullah Goranin, që morën një lloj forme të Solidarnostit polak dhe prinin në kundërshtimin e regjimit serb. Konkretisht kjo mbështetje u ndërlidh kur Dukagjin Gorani vizitoi disa qendra evropiane, duke përfshirë Oslon si pjesë e lobizmit të koordinuar nga Ibrahim Kelmendi (dhe qëndroi për disa ditë te Nufri Lekaj në Oslo). Në fakt, u arritën disa rezultate për ndërkombëtarizimin e kësaj çështje; takime me sindikatat norvegjeze etj., edhe në kuptimin se njeriu i dytë i Solidarnostit polak, Bogdan Karunda, ka folur në një konferencë në Oslo për shtypjen e klasës punëtore në Kosovë. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e bashkatdhetarëve në Norvegji mblodhën ndihma financiare për sindikatat e pavarura të Kosovës.

GBKNH ndihmoi edhe në promovimin e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në Evropë, (gjatë të ashtuquajturit Udhëtimi Evropian, më 20-25 gusht 1990, në Kopenhagë, Malmo, Oslo, Gjenevë, Cyrih, Bruksel), duke përfshirë edhe organizimin e konferencës në Oslo për Josef Diogardin, Osman Osmanin, Mehdi Hajdarin etj. Konferenca përfshiu edhe përfaqësuesin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë (KMDLNJ), Zekeria Canën. Shih në lidhje me këtë në vijim një faksimile/dokument dhe një foto:

ALBANIAN AMERICAN CIVIC LEAGUE
717 2ND STREET, N.E.
SUITE 303
WASHINGTON, D.C. 20002
(202) 547-3637
FAX (202) 547-3639

EUROPEAN TRIP

Prof. Dr. Zekeria Cana
Secretary of the Committee for the Defense of Human Rights and Liberties in Kosova

Hon. Joseph J. DioGuardi
Former United States Congressman &
President of the Albanian American Civic League

Mr. Osman Osmani
Board Member of the Albanian American Civic League &
Finance Committee Co-Chairman

Mr. Mehdi Hajdari
Board Member of the Albanian American Civic League

Sunday, August 19, 1990
Leave JFK Airport New York at 8:00 p.m. for Denmark

Monday, August 20, 1990
Place: Copenhagen, Denmark
Contact: Mehat Zemberi
Phone#: (011) 45-3-119-5178

Tuesday, August 21, 1990
Place: Malmo, Sweden
Contact: Sabri Novosella
Phone#: (011) 46-40-112-636

Wednesday, August 22, 1990
Place: Oslow, Norway
Contact: Nufri Leka
Phone#: (011) 47-2-449-579

Thursday, August 23, 1990
Place: Geneva, Switzerland
Contact: Hysen Gervalla
Phone#: (011) 41-6-635-6681

Friday, August 24, 1990
Place: Zurich, Switzerland
Contact: Hysen Gervalla
Phone#: (011) 41-6-635-6681

Saturday, August 25, 1990
Place: Brussels, Belgium
Contact: Gani Azemi
Phone#: (011) 32-1-760-837

Sunday, August 26, 1990
Leave Brussels for New York, U.S.A.

NOTE

EACH COUNTRY WILL BE HOSTING A BENEFIT DINNER, PRESS CONFERENCE AND WILL MAKE ARRANGEMENTS FOR DR. CANA AND THE CIVIC LEAGUE OFFICIALS TO MEET WITH GOVERNMENT REPRESENTATIVES WHERE EVER POSSIBLE!!

Konferencë për shtyp (1990) në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (KNH): Osman Osmani, Joe Dio Guardi, Zekeria Cana, Mehdi Hajdari, Nufri Lekaj.

Nufri Lekës, në cilësinë e përgjegjësit të GBKNH-s, nga viti 1988 i jepej mundësia që si delegat nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit (KNH), të takojë nëpër konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, personalitete me influencë politike, ku e shfrytëzonte rastin në maksimum edhe gjatë bisedave joformale, duke i informuar më hollësisht për shkeljet e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi dhe duke dhënë argumente për kërkesën "Kosova Republikë" si zgjidhje kompromisi dhe si zgjidhje që stabilizon politikisht Ballkanin. Rrjedhimisht, përveç të tjerash, prej datës 18 deri më 21 tetor 1990, në cilësinë e delegatit nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, u ftua të marrë pjesë edhe në mbledhjen themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë, e cila mbledhje ishte e sponsoruar nga një ndër iniciuesit e saj, Vaclav Havel, i cili, gjithashtu sikurse disidenti tjetër çek Jarosllav Shabata, në mënyrë implicite ishin për krijimin e strukturave të reja panevropiane, që nënkuptonte një riorganizim panevropian, duke filluar nëpërmes Asamblesë Qytetare të Helsinkit. Edhe GBKNH e përkrahte këtë ide, ngaqë shpresohej se Kosova do të mund të faktorizohej politikisht nëpërmes konceptit të të drejtave të njeriut, duke u anëtarësuar në një ristrukturim të ri organizativ panevropian në përpjekjet për t'u dekolonizuar nga Serbia në bazë të parimit për vetëvendosje. Por, ideja e sllovenit Tomazh Mastnak përkrahej më shumë, që Asambleja Qytetare e Helsinkit të mbetet një organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve. Në kuadër të kësaj mbledhje, më 20 tetor u mbajt një tribunë e veçantë për Kosovën, Irlandën veriore dhe Transilvaninë, ku përgjegjësi i GBKNH-s, Nufri Lekaj, i bëri një kritikë qasjes që dominonte në diskursin e politikës perëndimore që, duke u thirrur në emër të një Evrope të bashkuar dhe të integruar, njëkohësisht ndërkomunikohej e drejta për vetëvendosje për shqiptarët në Jugosllavi. Rrjedhimisht, shpresën për një Evropë të bashkuar dhe të integruar, që parashihte ta përfshinte edhe Ballkanin dhe që nuk merrte parasysh zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, në fjalimin e tij në këtë tribunë, përgjegjësi i GBKNH-s, Nufri Lekaj, e cilësoi si: një eufori utopike që vetëm zëvendëson euforinë utopike të socializmit nga e cila mezi kishim dalë dhe se nuk guxojmë të mashtrohemi prapë, sidomos ne shqiptarët, sepse pa u zgjidhur çështjet e pazgjidhura nacionale në Evropë, në veçanti çështja shqiptare në Jugosllavi, nuk mund të shpresojmë për një Evropë të bashkuar dhe të integruar. I pranishëm ishte edhe delegacioni nga Kosova i kryesuar nga Shkëlzen Maliqi, i cili, në lidhje me këtë mbledhje themeluese të Asamblesë Qytetare të Helsinkit në Pragë (duke e përfshirë edhe këtë fjalim të përgjegjësit të GBKNH-s), ka shkruar dhe botuar një shkrim në gazetën "Koha" më 3 nëntor 1990, i cili mund të lexohet në vijim:



ASAMBLEJA QYTETARE
E HELSINKIT — PRAGË 1990

INSTITUCION I LIRISË

SHKËLZEN MALIQI

Muajin që shkoi, prej 18 deri më 21, në Pragë u mbajtë mbledhja themeluese e Asamblesë Qytetare të Helsinkit (Helsinki Citizens' Assambly) me më shumë se 700 pjesëmarrës nga të gjitha vendet e Evropës, pos Shqipërisë. Asambleja u konvokua në mbështetje të iniciativës të një grupi ish-disidentësh të Evropës Lindore, të disa intelektualëve të angazhuar në lëvizjet shoqërore dhe të organizatave që mirren me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të qytetarëve dhe të pakicave të të gjitha llojeve (pakicat kombëtare dhe gjinore, emigrantët dhe azilantët, të hendikepuarit, homoseksualët etj.), të cilët në pranverë të këtij viti e shpallën Apelin e Pragës 1990 të Qytetarëve të Helsinkit. Porosia kryesore e këtij Apeli ka qenë se procesi i Helsinkit, gjegjësisht i sigurisë dhe i bashkëpunimit në Evropë, është tejet i rëndësishëm që të lihet vetëm në duart e qeverive dhe të politikanëve, të cilët në veprimet dhe vendosjet e tyre janë të kufizuar nga obligimet dhe prioritetet nacionale. Asambleja u paramendua si një forum i përhershëm dhe publik i grupeve për paqe dhe i shoqërive civile, si dhe i individëve dhe institucioneve që reprezentojnë mendimet dhe iniciativat e ndryshme qytetare. Në projektin e konvokuesve të Asamblesë thuhej se kapërcimi i ndasive në Evropë dhe integrimi i saj nuk është vetëm obligim i qeverive, por i të gjithëve, sidomos shoqërisë civile (civil society), i qytetarëve që bashkëveprojnë në shoqata, lëvizje, institucione, iniciativa dhe klube të vetorganizuara që synojnë kapërcimin e kufijve nacionalë, formimin e raporteve të reja shoqërore dhe të forumeve për dialog dhe negociata me qeveritë dhe të tjerët, duke përdorur edhe presionet ndaj institucioneve politike që të zgjidhen çështjet jetike me vetiniciativë dhe pa përzierje direkte të pushtetit, dhe, më në fund, që të angazhohen për zhvillimin e sferës së aktiviteteve publike (d.m.th. joshtetërore dhe joprivate) dhe të opinionit publik evropian.

Vaclav Haveli, njëri nga iniciatorët e këtij forumi dhe sponzori kryesor politik i tij, në hapjen e seancës së parë plenare u deklarua për krijimin e strukturave të reja panevropiane, duke i dalur në krah ideve të «shtëpisë evropiane», për të cilën flet Gorbaçovi, apo konfederatës së Miteranit, pra të një Evrope të re që do të jetë «oazë e paqes».

Organizatë qeveritare apo qytetare?

Nisma e Asamblesë, megjithatë, nuk ishte aspak e mbarë. Madje para se ajo të konstituohej si duhet dhe para se t'i bëjë hapat e parë, vetë, anëtarët e Këshillit organizativ kishin mosmarrëveshje konceptuale se çfarë duhet të jetë ky forum i qytetarëve të Evropës. Jaroslav Shabata, disidenti i njehur çek, duke vlerësuar ndryshimet në Evropën Lindore, doli me konstatimin se këtu shoqëria civile ka ardhur në pushtet dhe se është arritur demokracia. Ndaj këtij pohimi reagoi ashpër Tomazh Mastnak nga Sllovenia, duke thënë se shoqëria civile nuk është shaka dhe se ajo nuk mund të identifikohet me shoqërinë ekzistuese, e aq më pak me pushtetet e reja parlamentare të Lindjes. Me rënien e një sistemi totalitar dhe zgjedhje të lira nuk janë bërë ndryshime radikale, dhe tashtë gjithkund po paraqiten shenjat e qarta të vendosjes së totalitarizmit të ri nacional (nacionalizmat sundojnë Evropën Lindore). Thënë ndryshe, këtu janë bërë vetëm hapat e parë drejt demokracisë së njëmendtë. Po edhe sikur pushteti i ri të jshte krejtësisht demokratik, duhet dalluar pushtetin nga shoqëria civile – konkludoi Mastanaku. Shabota për paraqitjen e këtillë tha se është ultraradikale dhe se me të mohohet legjitimiteti i zgjedhjeve që thyen sistemin njëpartiak dhe inauguruan demokracinë parlamentare. Mos, kështu, Mastnaku e mohon edhe vullnetin e shprehur lirisht të qytetarëve në Evropën Lindore?

Prapavija e këtij konflikti kishte të bëjë me dilemat rreth strukturës organizative të AQSH, se a do të përbëhet kjo Asamble vetëm nga përfaqësuesit joqeveritarë dhe jopolitikë (në kuptimin e ngushtë të fjalës) apo edhe nga përfaqësuesit e partive politike, madje edhe të atyre që janë në pushtet. Konkretisht dilema shtrohej rreth disidentëve të dikurshëm që tani kanë ardhur në pushtet? A duhet përjashtuar ata nga ky forum i qytetarëve? Mos vallë ata tashti po reprezentuekan ideale të ndryshme dhe të kundërta nga ato kur kanë qenë të ndjekur dhe kur ishin në radhët e para të luftës për të drejtat e njeriut dhe shoqërinë civile?

Analitikët më të thellë në ten dencën për futjen e strukturave legale të qeverive në këtë Asamble Qytetare identifikuan tendencën e shndërrimit të kësaj iniciative në një institucion të parë të integrimit shtetëror gjithevropian, gjegjësisht ambicien e Havelit dhe të Shabotës që Praga të marrë primatin nga Helsinki dhe sidomos Strazburgu, duke e shndërruar gradualisht Asamblenë Qytetare në Parlamentin e Konfederatës apo Federatës Evropiane e Pragën në kryeqytet të Evropës.

Megjithatë, kjo polemikë përfundoi me fitoren e vijës së Mastnakut, sepse në këtë tubim kishte pak qeveritarë: AQSH-ja mbeti organizatë e asociacioneve të ndryshme joqeveritare të qytetarëve, si forum i përhershëm me seli në Pragë që do të merrte me çështjet e sigurisë dhe të paqes në Evropë, të çarmatimit dhe demilitarizimit, të drejtave të njeriut dukë përfshirë këtu edhe të drejtat e pakicave kombëtare, të zhvillimit ekonomikë dhe problemeve të ruajtjes së ambientit të jetës, të zgjidhjes së konflikteve të ndryshme shoqërore e nacionale (nacionalizmat e të tjera), të shoqërisë civile dhe të institucionalizimit të proceseve të integrimit të Evropës, të pozitës së femrës, të shtresimit social, të emigrantëve etj.

Ëndrrat dhe ëndrallat e Evropës

«Ëndrrat janë pjesa esenciale e realitetit» thotë Haveli. Çfarë është realiteti i Evropës dhe çfarë është ëndrra mbi te? Nga fjalët e shumë diskutuesve si në mbledhjet plenare, ashtu edhe në ato të komisioneve dhe nënkomisioneve të shumta, del se ky realitet, megjithatë është më i hidhur se sa duket dhe se ëndrrat mbi Evropën ndeshen me ëndralla të shumta. Në Asamblenë e Pragës u qanë pothuajse të gjitha hallet dhe problemet që politika zyrtare nuk i sheh apo i minimizon dhe i zbukuron me shifra mashtruese të mesatareve statistikore e që në jetën e përditshme krijojnë atë tablo të zymtë të fatalitetit të shtresave shoqërore të marginalizuara. Mbase edhe nuk ka mundur të gjendet vend më i përshtatshëm për t'u ambientuar në atë njëkohësi të madhështisë dhe të zymtësisë së Evropës, siç është Praga sot me bukurinë e papërshkrueshme të godinave, të kishave, të pallateve dhe të urave të saja të vjetra dhe me zbrazëtinë e varfërinë e jetës se njerëzve që jetojnë këtu dhe që sillen si fantazma të pashpirta, të ngrysyr, me lëvizje rrobotike që të lënë përshtypjen e kotësisë dhe të anemisë së përgjithshme. Socializmi dhe pushtimi gjakpirës 45–vjeçar sovjetik Pragën vërtet e shndërroi në atë kështjellë të ankthit nga ëndrrat e këqia letrare të Franc Kafkës, qytetar i këtij vendi përrallor, ku bukuria e sendeve duket aq e llahtarshme.

Vetë çekët dhe sllovakët ankoheshin: një vit pas revolucionit këtu asgjë esencialisht nuk ka ndryshuar. Po kështu ankoheshin lituanezët, ukrainasit, rumunët, hungarezët,por edhe polsët, baskët, irlandezët nga Alsteri... Se edhe Evropa Perëndimore nuk është parajsë e demokracisë fuqishëm dëshmoi pakistanezja , Roshan Dhunjiboi, gazetare dhe regjisore e filmit, duke folur për dekolonizimin e papërfunduar dhe katastrofën psikologjike të qyteteve industriale në Evropë, të getove të zezakëve, të arabëve, të indusëve e të refugjatëve, emigrantëve ekonomikë dhe azilantëve politikë të ndryshëm që assesi nuk mund të integrohen në Evropën dhe assesi nuk mund të bëhen evropianë deri sa dominon mentaliteti racist evropocentrik sipas të cilit këta ardhacakë përgjithmonë mbesin «të huaj».

Kosova, Irlanda veriore, Transilvania

Më 20 tetor në mbrëmje u mbajt një tribunë e veçantë kushtuar problemeve të Kosovër, Irlandës Veriore dhe Transilvanisë, ku morën pjesë, ndër të tjerët, shkrimtarja e re Nerimane Kamberi dhe autori i këtij shënimi. Nerimanja prezentoi gjendjen aktuale në Kosovë (shih tekstin në kornizë), e dëgjuesit kërkuan sqarim dhe plotësim rreth rezistencës së padhunshme: si është e mundur një rezistencë e tillë në kushtet e represionit aq të ashpër, dhe a është kjo një gjë e rastit apo e programuar? Qytetarët e Evropës, aktivistët e lëvizjeve paqësore, shprehnin një admirim të thellë ndaj rezistencës së tillë shqiptare. Kjo tribunë e mbrëmjes, sikur edhe e gjithë puna e Asamblesë, bëri vetëm një inventurë të problemeve dhe përcaktoi format e para organizative, dhe kornizat e para të drejtimeve të zhvillimit të punës së këtij forumi të parë të lirë gjithevropian, që u quajt edhe institucion i lirisë, sepse, siç u tha jo një herë, edhe liria kërkon institucionet e veta.

Takuam në këtë tubim edhe një shqiptar të arratisur nga Kosova, Nufri Lekaj, azilant në Norvegji, ish i burgosur politik dhe ish – anëtar i Lëvizjes marksiste – leniniste, intelektual brilant dhe aktivist i Federatës së Helsinkit për të drejtat e njeriut, i cili po ashtu, duke shikuar gjithë atë turmë të reprezentëve të margjinalëve të Evropës, vërtetoi fjalët e pakistanezes, Roshan Dhunjiboi dhe na tha një mendim të hollë të cilin duhet mbajtur mend: «Gjithë kjo eufori mbi Evropen e bashkuar dhe të integruar më duket si një utopi e re që po e zë vendin e ëndrrës së socializmit nga e cila mezi dolëm të gjithë! Mos të mashtrohemi edhe nga kjo ëndërr sidomos ne shqiptarët!!!

Po e përfundoj këtë shkrim me një grafit nga një muri i qytetit të vjetër Hradçani, që shpreh po ashtu shqetësime të ngjashme dhe frymën e përgjithshme të kohës dhe ambientit ku u mbajt Asambleja Qytetare: **«Porazyt a ne byt porazeny?»** (Të ngjadhënjesh e të mos jesh i ngadhënjyer?).

A është e mundur, pra, të ngadhënjejë Evropa e të mos jenë të ngadhënjyer qytetarët e saj?

Që nga viti 1988 GBKNH e arriti kuptueshmërinë në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (si organizatë gjysmështetërore), se kërkesa "Kosova Republikë është zgjidhja më e mirë e problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi" dhe, kështututje, loboi në vazhdimësi që të kihet kuptueshmëri për këtë kërkesë, edhe në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe në kuadër të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE-s). Pas zhvillimit të ngjarjeve, kjo kërkesë rezultoi edhe si qëndrim zyrtar i Komitetit Norvegjez të Helsinkit. Përkatësisht, pas iniciativës dhe insistimit të vazhdueshëm të përgjegjësit të KBKNH-s, në Komitetin Norvegjez të Helsinkit, por edhe sqarimit të perspektivës politike për çështjen e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, në mbledhjen vjetore të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, mbajtur në godinën e parlamentit norvegjez më 19.03.1991, sekretari gjeneral i Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Bjørn Catto Funnemark, propozon publikisht, dhe unanimisht aprovohet si një nga pikat e "këshillimit" të politikës së jashtme norvegjeze: "Kosova Republikë është zgjidhja më e mirë e problemeve serioze e të drejtave të njeriut në Jugosllavi". Ky amendamentim nga ana e një organizate gjysmë shtetërore ishte shumë i rëndësishëm për kohën, mbase rasti i parë kur bëhen propozime për zgjidhje politike, dhe një forcim i ndikimit lobist dhe i diplomacisë joformale të Kosovës në Norvegji dhe në përgjithësi në Skandinavi. Në vijim, një shkrim/artikull informativ në lidhje me këtë:



4 Shkëndija
PRILL 1991

ENKAS PËR «SHKËNDIJËN»

NORVEGJIA FILLON TË REAGOJË

Populli shqiptar në Jugosllavi publikisht dhe juridikisht bëri deklarimin e vet rreth zgjedhjes së fatit të vet, zgjedhje që në mënyrë paqësore dhe njerëzore u kurorëzua me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave.

Këtë vendim historik të shpalljes juridike të shtetit të dytë shqiptar, politika serbe shpejt e shpalli jo të ligjshëm, sepse qenka bër në ilegalitet, por ato vendime historike bota i regjistroi me një interesim të madh dhe me simpati ndaj luftës paqësore të popullit shqiptar në Jugosllavi. Si rezultat i kësaj ishin shumë deklarata e rezoluta nga të gjitha anët e botës.

E tillë ishte Rezoluta e miratuar më 19 mars 1991 në Oslo të Norvegjisë prej anës të KOMITETIT KOMBËTAR NORVEGJEZ TË FEDERATËS SË HELSINKUT — për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Kongresi KKNH u mbajt në sallën e plotë të Parlamentit Norvegjez (Stortinget). Për të treguar për rëndësinë e këtij vendimi duhet shpjeguar se çfarë roli luan KKNG në relacion me politikën e jashtme të Norvegjisë në përgjithësi e në fushën e të drejtave të njeriut në veçanti të cilat shikohen përmes prizmit të Marrëveshjes së Helsinkit, që në realitet është një akt politik dhe çdo shtet që ble nën thumbin e kritikës të KKNH vëhet për refleksin e politikës norvegjeze ndaj atij shteti (kushtetuta Norvegjeze ndërtohet në tri themele kryesore e njëri ndër to është e drejta dhe liria e plotë e njeriut). Në anën tjetër, KKNH në radhët e veta ka personalitete të rëndësishme politike (P.sh Reulf Steen, nënkryetar i partisë në pushtet Arbeiderpartis) që është zgjedhur kryetar këshilli të KKNH-s, njerëz nga jeta kulturore, e humanistë të njohur që deri dje kanë qenë në Komitetit për dhënien e Çmimit Nobël për paqe.

Prandaj, rezoluta e miratuar është një vendim dmth. si fillim i reagimit zyrtar të shtetit norvegjez në lidhje me Republikën e Kosovës.

Për ta bërë të njohur këtë rezolutë po e shënojmë të përkthyer nga norvegjishtja:

«IV rezolutat

JUGOSLLAVIA/KOSOVA: Kongresi i KKNH-së kërkon që të gjithë të burgosurit politikë të lirohen menjëherë. Tani gjenden më shumë se 100 të burgosur politikë në Jugosllavi — që të gjithë shqiptarë nga Kosova.

Kongresi i KKNH kërkon nga Qeveria (norvegjeze) ta diskutojë këtë dhe shkeljet e tjera të rënda të njeriut në mënyrë direkte me pushtetin në Beograd. Kongresi posaçërisht veçon sjelljen e gjendjes së urisë te shqiptarët në Kosovë dhe mbylljen e shkollave dhe të universitetit në gjuhën shqipe.

Kongresi i KKNH-së mendon se shqiptarëve duhet t'u jepen të drejta të barabarta si popujve të tjerë në Jugosllavi. KKNH mendon se ky është kusht i domosdoshëm, i cili do të sjellë deri zbutjen e situatës në vend. Kongresi i KKNH-së mendon se kërkesa për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës apo konfederatës jugosllave është një kërkesë e drejtë, e cila do ta zbutë situatën e tendosur në Jugosllavi».

Nga kjo Rezolutë shihet se Evropa përkrah ngadalë kërkesat tona dhe ngadalë la paguan borxhet e veta popullit shqiptar. Mirëpo, ne duhet të përgatitemi mirë që të jemi ata të cilët kurorëzojnë fitoret e bota duhet t'i përkrahë, sepse ne jemi ata që duhet përkrahur, se bëjmë luftë paqësore dhe të drejtë. Kushti kryesor për t'ia dalë punës në fund është vendosmëria jonë për të shkuar më tutje dhe jetësuar vendimet e Kaçanikut. Posaçërisht kjo vendosmëri na duhet tani kur si shumë herë më parë fatin e Jugosllavisë e vendosin serbët dhe kroatët, por tani s'ka vendim që do të jetë koherent pa dëshirën e popullit shqiptar. Këtë e ka kuptuar bota e shpresojmë se do ta kuptojnë edhe serbët e kroatët.

Nufri R. LEKAJ
Oslo, Norvegji

Në vazhdën e pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përgjegjësi i GBKNH-s, Nufri Lekaj, merr pjesë edhe në konferencën në Veronë (Itali) prej 17 deri më 20 shtator 1992 e ashtuquajtur "Forumi për Paqe dhe Pajtim në ish-Jugosllavi" ku, përveç të tjerëve, morën pjesë përfaqësues nga Federata e Helsinkit, Asambleja Qytetare e Helsinkit, Jugofax (Londër) dhe nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në Oslo. Konferenca u udhëhoq nga një komitet prej 13 personash, në krye me Alexander Langer (anëtar i Parlamentit Evropian dhe president i Grupit Greens/EFFA në Parlamentin Evropian) dhe nga znj. Marijana Grandits nga Austria. Konkretisht, konferenca kishte të bënte me propozimet për gjetjen e zgjidhjes së krizës politike në Jugosllavi. Në këtë konferencë në delegacionin nga Norvegjia, Nufriu ishte së bashku me profesorin e filozofisë, Tore Lindholm. Gjatë kësaj konference, në kuadër të delegacionit skandinav, Nufriu pati rastin të marr pjesë në një darkë joformale me Alexander Langer dhe gjatë një bisede me të, duke menduar se është norvegjez dhe, pasi e kuptoj se ishte shqiptar, u bë kurioz të dijë më shumë për Kosovën, dhe përveç tjerash u argumentua se kërkesa "Kosova Republikë nënkupton zgjidhjen më të mirë të problemeve serioze të të drejtave të njeriut në Jugosllavi". Konkluzat e Konferencës së Veronës e vitit 1992, u botuan edhe në gazetën zyrtare Appell të Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Vlen të theksohet se gazeta zyrtare periodike – vjetore "Appell" e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, e kishte ndikimin e vet në diskursin mediatik norvegjez, njëherësh, disa nga artikujt që shkruheshin në këtë gazetë në lidhje me çështjen e Kosovës, përkutheheshin në gjuhën angleze dhe shpërndaheshin në kuadrin e informacionit për Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit, duke e përfshirë edhe Human Rights Watch. Nufriu kontribuonte edhe me kolumne për këtë gazetë, në veçanti në lidhje me situatën në Kosovë. Në njërën nga këto kolumne e vitit 1991, e titulluar *Kosova dhe shqiptarët, të harruar nga Evropa*, shpreh indinjatën e tij që BE-ja i ka ftuar të gjitha republikat jugosllave në negociatat në Hagë, por ka harruar ta ftojë edhe republikën e shtatë, republikën e Kosovës, ku përveç tjerash shkruan: "…….*Duhet ripërsëritur se përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë qenë kurrë të drejtuara për ta shkatërruar Jugosllavinë, por gjithnjë kanë qenë përpjekje për pavarësinë dhe barazinë e shqiptarëve në raport me republikat e tjera. Këto përpjekje u kanë kushtuar shqiptarëve shumë, në veçanti në 10 vjetët e fundit. Disa qindra janë vrarë gjatë demonstratave dhe protestave, qindra të tjerë janë plagosur dhe mijëra të tjerë janë burgosur dhe internuar për veprimtari politike. Përafërsisht 100 000 shqiptarë janë përjashtuar nga vendet e tyre të punës (nga sistemi gjyqësor, administrata, shëndetësia, policia, posta, universiteti, shkollat etj.) për shkak të bindjeve të tyre politike. Tani në këto vende të punës, në vend të shqiptarëve, janë kyçur kolonialistët serbë, të cilët marrin paga të dyfishuara krahasuar me pagat që kishin shqiptarët në këto vende të punës. Rrjedhimisht, Kosova është një "zonë autonome" e okupuar nga një fuqi koloniale me emrin "shteti i Serbisë". Republikat e tjera në Jugosllavi e kanë ekskluduar Kosovën dhe shqiptarët në përpjekjet për një zgjidhje të konfliktit në Kosovë. Shqiptarët e kanë kuptuar këtë qëndrim të republikave të tjera jugosllave (të populluara kryesisht me banorë me origjinë sllave) që nënkupton se nuk dëshirojnë t'i pranojnë shqiptarët të jenë të barabartë me popujt e tjerë në një Jugosllavi të re, duke i lënë kështu shqiptarët të mbesin një koloni e Serbisë. Mbas një përpjekje nga ana e Perëndimit, shqiptarët filluan të shpresojnë për një të ardhme më të mirë. Këshilli i Evropës i ka dënuar shkeljet e të drejtave të njeriut nga regjimi serb në Kosovë. Të njëjtën gjë e ka bërë Kongresi Amerikan, gjithashtu edhe partitë politike dhe organizatat për të drejtat e njeriut. Shqiptarët me udhëheqjen e tyre demokratike dhe "Gandin e shqiptarëve", dr. Ibrahim Rugovën, kanë krijuar simpati në vijën e tyre politike kundër regjimit shtypës serb. Pavarësisht provokimeve dhe represioneve nga ana serbe, asnjë serb në Kosovë nuk është dëmtuar, plagosur ose vrarë nga shqiptarët. Kjo tregon se me çfarë lloj konflikti kemi të bëjmë: një luftë e pastër çlirimtare me mjete demokratike kundër një pushtuesi kolonialist. Shpresat e shqiptarëve për ndihmë nga Perëndimi*

kanë filluar të zbehen. BE-ja i ka ftuar të gjitha republikat jugosllave në negociatat në Hagë, por ka harruar ta ftojë edhe republikën e shtatë, republikën e Kosovës. Pse? A duhet Kosova të sakrifikohet për interesat serbe dhe kroate? A do ta përsëritë Evropa, Londrën dhe marrëveshjen e Versajës për Jugosllavinë, e përsëri t'i sakrifikojë shqiptarët për Serbinë? Ky neglizhim ndaj shqiptarëve në Jugosllavi tregon se BE-ja po e përgatit një marrëveshje të re për Jugosllavinë, që nuk merr parasysh interesat e shqiptarëve. Në Londër dhe Versajë ka qenë më e lehtë për të bërë këtë. Por tani situata është krejtësisht ndryshe në Evropë, ku demokracia dhe liria janë fjalët më të dashura të kombeve të shtypura dhe do të jetë e vështirë për çdo shtet tjetër dhe për BE-në për të luajtur me fatin popujve të shtypur. Në veçanti kur është fjala për shqiptarët, kjo është një lojë e rrezikshme. S'duhet të harrohet se shqiptarët në Jugosllavi janë populli i tretë për nga madhësia demografike (3 milionë) sa e gjithë popullsia në Shqipëri. Nëse vazhdohet të shpërfillen shqiptarët, ata do të detyrohen për atë që ne të gjithë duhet të përpiqemi ta parandalojmë, për një konflikt të armatosur me pushtetin kolonial serb. Një situatë e tillë mund të çojë edhe në ndërhyrjen nga Shqipëria për t'i ndaluar krimet e luftës ndaj shqiptarëve në Kosovë (çfarë teknologjie ushtarake ka Serbia tregohet edhe nëpërmes eksportit të armëve të Serbisë në Irak). Është e qartë se nuk dëshirojmë të ndodhë një zhvillim i tillë në Ballkan. Prandaj është shumë e rëndësishme për të gjitha palët në tryezën e bisedimeve të mos i harrojnë shqiptarët të cilët kanë vullnet për bashkëpunim dhe duan të marrin pjesë në negociata….." Gjithashtu, në këtë vazhdë, në kuadër të shkrimeve për gazetën zyrtare "Appell" të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, Nufriu në shkrimin e tij në numrin 1 të vitit 1993, të gazetës Appell, shpreh indinjatën për shpërfilljen e faktorit politik shqiptar në kuadër të procesit të njohjes së Maqedonisë, në lidhje me këtë në këtë shkrim të tij të titulluar*: Maqedonia drejt njohjes, por çka me shqiptarët*?, përveç tjerash shkruan: *"....Një Maqedoni e cila nuk respekton shqiptarët dhe të drejtat e tyre nuk do të jetë vetëm një shtet i brishtë, por ndoshta edhe një vend konflikti i ngjashëm me atë në Kroaci dhe Bosnjë. Bashkimi Evropian dhe Perëndimi në përgjithësi duhet t'u bëjnë presion pushtetarëve maqedonas për t'i respektuar shqiptarët dhe t'i bëhet presion Greqisë për ta pranuar shtetin me emrin Maqedoni."*

Rrjedhimisht si orientim më konkret në lidhje me këtë, në vijim janë të faqosura tri faksimile, nga gazeta zyrtare Appell e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, përkatësisht kopja e shkrimit të sipërcekur të Nufriut për këtë gazetë, i titulluar *Kosova dhe shqiptarët, të harruar nga Evropa*, më tutje është kopja e kësaj gazete në lidhje me *Konkluzat e Konferencës së Veronës e vitit 1992*, dhe më tutje është shkrimi tjetër i sipërcekur i Nufriut për këtë gazetë, i titulluar *Maqedonia drejt njohjes, por çka me shqiptarët*? :

APPELL

Utgitt av Den Norske Helsingforskomité — APPELL NR. 2 1991

Kosovo og albanerne glemt av Europa

Av Nufri R. Lekaj

[illegible]

Borgerkrigens glemte politiske fanger

[illegible]

Disse politiske fangene soner dommer på 10 år eller mer:

[illegible]

Konklusjoner fra Veronakonferansen

"Forum for fred og forsoning i ex-Jugoslavia" møttes i Verona 17-20 september 1992. Tilstede var 52 deltagere fra mer enn 50 forskjellige frivillige organisasjoner og politiske partier fra alle regioner i det tidligere Jugoslavia. Videre deltok 50 observatører fra hele Europa, inklusive representanter fra International Helsinki Federation, Helsinki Citizen Assembly, Yugo-Fax (London) og Institutt for Menneskerettigheter (Oslo). Konferansen ble ledet av en komite på 13 personer, med Marijana Grandits (Østerrike) og Alexander Langer (italiensk medlem av Europaparlamentet), som formenn.

Konferansen tok sikte på følgende:

Å få fram nye og alternative forslag til fred og forsoning ved å trekke inn et vidt spekter av representanter fra det sivile samfunnsliv i det tidligere Jugoslavia.

Dessuten, at konferansen skulle fungere som en innledning til en mer permanent dialog mellom partene, og ved å påvirke den internasjonale fredsprosessen. Dette søkes gjennomført ved å utvikle samarbeidet med den alternative konferansen for fred på Balkan (London, august og "Citizens Peace Conference" (Ohrid, Makedonia, november 1992) og ved å trekke inn nye grupper og parter i samarbeidet.

Generelle prinsipper:

Forumet konstaterte;

1) Massive brudd på internasjonale menneskerettigheter og humanitær lovgivning.

2) Garantert ekspansjon av konflikten.

3) Den internasjonale fredsprosess' manglende vilje til å gjenopprette fred og orden.

4) Mangelen på en politisk løsning som omfatter hele Balkan-området.

5) At grunnleggende demokratisk tankegods og menneskerettigheter aldri har fått riktig fotfeste i området.

Forutsetninger for en resolusjon:

1) Umiddelbare og permanente forholdsregler for å stoppe volden, herunder bombing, skyting, fordrivelse, tortur, terror, etnisk utrenskning og andre måter å føre krig på.

2) Å påpeke nødvendigheten av å respektere alle internasjonale resolusjoner, avtaler og lover, og i særdeleshet det som vedrører humanitære forhold. I denne sammenheng nevne overgripernes personlige straffeansvar etter folkeretten.

3) Opprette demokratiske institusjoner og styrke det sivile samfunnsliv ved å stimulere demokratiske krefter og bruk av internasjonale fredsskapende sanksjoner.

4) Territorial og demografisk status quo ante som vil danne basis for fremtidige bosettinger.

5) Partene i den offisielle fredsprosess, både det internasjonale samfunn og partene fra det tidligere Jugoslavia, må bestrebe seg på å sette egne interesser til side for å oppnå resultater.

Forslag til å stoppe krigen i Bosnia-Hercegovina;

Forumet ble enig om at den eneste mulige løsning på lengre sikt er å opprette et protektorat administrert av FN. Administrasjonen skal ha full kontroll over hele Bosnia-Hercegovina, og søke å demilitarisere og oppløse militsen og fornye den politiske struktur.

DEN NORSKE HELSINGFORSKOMITE

appell

Nr. 1/1993

Makedonia mot anerkjennelse, men hva med albanerne?

Av Nufri Lekaj

Det har i den siste tiden vært fokusert på Makedonia som en følge av at Hellas nekter å anerkjenne staten under navnet Makedonia, men hva skjer egentlig i Makedonia?

Makedonia som område i det gamle Hellas ble kjent under Alexander Den Store av Makedonia hvis far var gresk og mor albansk. Området var i denne perioden under gresk styre og beboddav grekere, slyrere (albanere) og trakere. På syvhundre-tallet kom slavere og tyrkere fra Bulgaria og bosatte seg i det østlige Makedonia. Den greske dominansen var på denne tiden for svak til å forhindre innvandring fra Bulgaria. Det medførte at det østlige og sør-østlige Makedonia allerede på 1000-tallet ble beboddav slaviske stammer. Nord- og vest-Makedonia beholdt sin etniske sammensetning som bestod av albanere, og var en del av det Albanske middelalderriket. Deler av Makedonia var beboddav Bulgarske makedonere som ble styrt av det bulgarske kongerike. Etter at serberne hadde okkupert Kosova, Nord-Albania, Montenegro og Hercegovina i det 7.de århundre klarte de nesten å okkupere det Bulgarske Makedonia. Det mektige serbiske kongerike ble slått av tyrkerne i 14.de århundre og som alle andre land på Balkan ble det makedonske område okkupert av tyrkerne.

Under den tyrkiske okkupasjonen, særlige i det 17.de århundre, begynte det å vokse fram en Makedonsk nasjonalisme som hadde en autonom holdning overfor den Bulgarske nasjonale bevegelse. På den tiden begynte befolkningen i det som i dag kalles Makedonia å kalle seg makedonere og skille seg fra bulgarere. Denne holdningen falt ikke i god jord hos bulgarerne, og den makedonske nasjonalbevegelsen ble i delt i to: autonome nasjonalister og pro-bulgarske nasjonalister. Den første gruppen var sterkest og allierte seg med albanerne som i denne perioden til sammen utgjorde ca.45% av befolkningen i Makedonia og som kjempet mot tyrkerne. Under ledelse av makedonere og albanere begynte frigjøringskampen mot tyrkerne. Den 2. august 1903 ble republikken Kruseve erklært grunnlagt, men etter kort tid ble republikken endret av tyrkere. Dette interesse har fått stor betydning for Makedonias historie og for såvel makedonere som albanere.

NY SERBISK OKKUPASJON

Allerede i 1912 okkuperte Serbiske styrker Makedonia og erklærte makedonerne for serbere. Det brøt ut krig mellom Serbia og Makedonia. Bulgaria tapte og Makedonia ble i likhet med Kosova en del av det Serbiske kongerike og senere Jugoslavia (etter første verdenskrig). Årene fra 1912 til 1940 kan anses som de vanskeligste for Makedonias befolkning. Hverken makedonerne eller albanerne hadde noen menneskerettighetsbeskyttelse og ble offisielt kalt serbere.

ANNEN VERDENSKRIG OG DEN MAKEDONSKE REPUBLIKK

Det Makedonske kommunistparti hadde kontakt med det Bulgarske kommunistparti. Komintems holdning før annen verdenskrig var at staten Jugoslavia skulle oppløse og flere selvstendige stater dannes. Makedonia skulle deles mellom Bulgaria og Albania. Kosova skulle tilhøre Albania. Etter at annen verdenskrig brøt ut gikk ansjoua listiske serbiske sosialister under ledelse Alexander Rankovic og Milovan Djilas mot Komintems linje. Også

ikke-kommunistiske serbiske ledere støttet dette i motsetning til makedonerne og albanerne. Det førte til en ny situasjon i Makedonia hvor flertallet av kommunistene som støttet den pro-bulgarske bevegelsen ville legge Makedonia under Bulgaria. De serbiske kommunistene sendte sine agenter til Makedonia i 1941/42 for å drive propaganda mot pro-bulgarere og for en makedonsk republikk i den jugoslaviske federasjon. Dette synet fikk større i den Makedonske nasjonalbevegelsen som støttet makedonsk autonomi med det til følge at det i 1943 ble dannet et nytt Makedonsk kommunistparti med pro-jugoslavere i spissen.

Det pro bulgarske partiet mistet etter hvert støtten som en følge av at Bulgaria var alliert med Tyskland og fordi mange bulgarere hadde sympati med Sovjet-Unionen. I 1943, 1944 og 1945 deltok makedonerne og albanerne aktivt i krigen mot Tyskland. Etter krigens slutt ble Makedonia republikk i Jugoslavia.

DE TIDLIGERE UNDERTRYKTE BEGYNNER Å UNDERTRYKKE

Etter krigen ble Makedonia dannet som et mønster for nasjonal rettferdighet, albanerne ble valgt og representert i statsapparatet på samme vilkår som makedonerne og Makedonia ble både Makedonsk og Albansk republikk. Dette varte bare i tre år som følge av den serbiske politikken. Serbisk politikk skremte makedonere med at albanerne ville overta styringen av Makedonia og at landet ville bli en del av Albania hvis albanerne fikk fortsette i sine posisjoner. Makedonerne ble oppfordret til å slå til mot albanerne på samme måte som serberne gjorde mot albanerne i Kosova og Montenegro. De makedonske nasjonalistene som var samlet rundt kommunistpartiet begynte allerede i 1948 å undertrykke sine naboer og faktisk hardere enn den serbiske undertrykkelsen i Kosova. For eksempel kan nevnes: Alle albanske politiske ledere og de som hadde vært motstandsfolk mot tyskerne under krigen ble fengslet og internert. Bøker og radioverk måtte på albansk ble forbudt, skoler stengt og de albanske navnene ble slavifisert osv.

I 1970-årene ble det litt mer liberalt som en følge av Titos oppgjør med Serbiske nasjonalister og i grunnloven av 1974 ble albanerne i Makedonia anerkjent som et folk og formelt likestilt. I praksis kom det frie ut av dette i en befolkning hvor albanere utgjør ca. 50% og som bare fikk lære og benytte sitt morsmål til og med fjerde klassetrinn, ikke utga en avis pr.uke, og sendte to timer pr. uke med albanske radioprogram. De nasjonalistiske krefter var fortsatt sterke både i lokal- og statsadministrasjon.

Året 1981 ble et vendepunkt for albanerne i Makedonia og Kosova. I Kosova krevde albanerne sin egen republikk. Kravet ble slått ned av en serbisk militær- og politiaksjon. Albanerne i Makedonia viste solidaritet overfor albanerne i Kosova noe som medførte at de makedonske nasjonalistene fratok albanerne de få rettighetene de hadde. De makedonske nasjonalistene ble igjen skremt av serbiske nasjonalisters propaganda om at hvis albanerne fikk en egen republikk i Kosova ville de også kreve områder i Makedonia. Det er ikke riktig. Fram til 1991 var det en systematisk makedonsk undertrykking og vandalisering av alt som er av albansk kultur og nasjonal tilhørighet. Politiske drap og fengslinger, riving av albanske boliger osv.

MAKEDONIA UNDER OPPLØSNINGEN AV JUGOSLAVIA.

Serbernes gamle argument om at Makedonia bare kan eksistere hvis det er en del av Jugoslavia har lenge blitt brukt også av pro-jugoslaviske makedonere. I det første frie valget i Makedonia vant et pro-jugoslavisk parti som nølte med å respektere valgresultatet i de byene hvor albanerne utgjør flertallet. Det ble hevdet at "vi kan ikke akseptere at en albaner blir ordfører i en makedonsk by" (albanerne er ikke verd en slik stilling). Etter krigen i Slovenia og Kroatia har inntil nylig denne pro-jugoslaviske holding blitt stadig svakere med det til følge at nasjonalistene i sentrum og de pro-bulgarske har dannet flertall i parlamentet og besterm seg for løsrivelse fra rest-Jugoslavia.

Samtidig vekser en makedonsk ide om at Makedonia vil klare seg som suveren stat. Serbia spiller på at en løsrivelse vil føre til at Makedonia vil bli delt mellom Bulgaria og Albania. Samtidig blokkerer det tradisjonelt allierte Hellas at EF anerkjenner landet under navnet Makedonia fordi det gamle Makedonia strekker seg inn i den nordlige Hellas.

Albanerne på sin side har flere ganger i det Makedonske parlament (25 representanter) forsøkt å overbevise makedonerne om at et stabilt og nøytralt Makedonia ikke kan eksistere uten albansk representasjon i offentlige organer. De nye makthaverne i Makedonia har til nå ikke etterkommet dette kravet. Det er er tegn på en uavklart fremtid og vil bare styrke posisjonene til den pro-serbiske og pro-bulgarske ide.

I påvente av en avklaring i den ene eller den andre retning lar albanerne i Vest-Makedonia utvholdt folkeavstemning om det bør opprettes et eget autonomt område i Hiirida innenfor den Makedonske stat. Flertallet gikk inn for dette, men man avventer å gjøre noe inntil begge parter kan finne en løsning. Albanerne støtter et selvstendig Makedonia der folkegruppene er likestilt.

Et stabilt forhold mellom albanerne og makedonerne i Makedonia vil ha stor betydning for landets fremtidige stabilitet og svekke den serbiske apetitt på makt i områder.

Det greske utspillet om at de ikke aksepterer navnet Makedonia fordi det er et gresk navn og frykten for at Makedonia vil kreve en provins i Hellas med samme navn er lite sannsynlig fordi det også i Bulgaria finnes en provins med samme navn. Fra et militært synspunkt vil Makedonia bli en svak faktor i forhold til Hellas og Bulgaria. Den greske motstanden mot dette er pisket opp av Serbia hvor Milosevic har foreslått et statsforbund overfor Hellas. Hvordan kan dette gjennomføres uten at Makedonia deles?

Den greske motstanden mot anerkjennelse under navnet Makedonia er kunstig når dette navnet har vært akseptert i 200 år. Hellas og resten av EF i likhet med verdenssamfunnet må være oppmerksom på den politiske og menneskerettslige situasjonen til albanerne i Makedonia. Et Makedonia som ikke tar hensyn til albanerne vil ikke bare bli en skrøpelig stat, men kanskje en konflikt lik den som er i Kroatia og Bosnia.EF og Vesten må presse Makedonske myndigheter til å respektere albanerne og Hellas til å anerkjenne staten under navnet Makedonia.

Me zhvillimin e ngjarjeve (pas shembjes së murit të Berlinit), ndikimi dhe ndihma e GBKNH-s nuk mungoi as për Shqipërinë. Kjo ndihmë u realizua në kuadër të një projekti shtesë të GBKNH-s, i ashtuquajturi projekti Aksioni Norvegji - Shqipëri (ANSh), i mbështetur drejtpërdrejt nga Ministria e Jashtme Norvegjeze (MPJN), përkatësisht ministri Johan Jørgen Holst. Ky projekt u udhëhoq nga Berit Backer (përgjegjëse e projektit) dhe nga Nufri Lekaj (koordinator i projektit). Fillimisht, nëpërmes këtij projekti u realizuan ndihmat emergjente nga Ministria e Jashtme e Norvegjisë për në Shqipëri dhe, në këtë vazhdë, me ndihmën e këtij projekti, u etablua OJQ-ja e parë në Shqipëri në vitin 1991, si bërthama e parë nga jashtë për të drejtat e njeriut dhe demokratizim në Shqipëri, përkatësisht Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe për Rehabilitimin e të Përndjekurve Politikë nga Regjimi Totalitar. Në fakt, kjo është OJQ-ja e parë e regjistruar në Shqipëri, e cila vazhdoi të funksionojë edhe pas vitit 1994 nën udhëheqjen e Kozara Katit etj. Gjithashtu, nëpërmes këtij projekti (ANSh-së) u ndihmua themelimi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHN-s) në vitin 1991, në bashkëpunim me Arben Puton dhe Kujtim Çashkun. Madje në kuadër të kësaj veprimtarie, Berit Backer, përveç të tjerash, ndihmoi që Shqipëria të përfaqësohet në takimin e ekspertëve të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE-s). Kështututje, në kuadër të veprimtarisë së këtij projekti (ANSh-së), në vitin 1993 Nufri Lekaj, si pjesë e koordinimit të Qendrës për Rehabilitimin e të Burgosurve Politikë në Tiranë me Qendrat Ballkanike, mori iniciativë, në takimin në Greqi, për etablimin e Qendrës në Kosovë për rehabilitimin e ish-të burgosurve politikë shqiptarë, e cila qendër u jetësua në vitin 2000 nga Feride Rushiti.

Shih në vijim një faksimile nga fjalimi i Adrian Katit me rastin e hapjes së punëtorisë së parë rajonale (një perspektivë rajonale Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni), i cili, gjatë fjalimit, përveç të tjerash, shpreh mirënjohjen për kontributin e Berit Backerit dhe Nufri Lekës. Kjo punëtori është organizuar nga Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës (QShRMT) në bashkëpunim me Rehabilitation and Research Center for Torture Victims (RCT), në Tiranë më 8-10 dhjetor 2000:

Qendra Shqiptare e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës

WORKSHOPI I -RË RAJONAL

"Trauma, Faktorët, Pasojat dhe Përballimi"

Një Perspektivë Rajonale: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

Tiranë
8-10 Dhjetor, 2000

Organizuar nga:
Qendra e Rehabilitimit për të Mbijetuarit e Torturës-QSHRMT

Në bashkëpunim me
Rehabilitation and Research Center for Torture Victims-RCT

Tiranë

FJALA E HAPJES NË WORKSHOP-IN E PARË RAJONAL

Të nderuar miq, të ftuar pjesëmarrës në këtë takim pune, mirë se keni ardhur! Në mënyrë të veçantë përshëndesim miqtë tanë të ardhur nga Prishtina dhe Tetova.

Do të doja të hapnim punimet e këtij workshopi duke nderuar viktimat e torturës kudo në botë me një minutë heshtje.

Jemi mbledhur së bashku, këtu në Tiranë, për të shkëmbyer mendime dhe përvoja lidhur me punën tonë fisnike për të lehtësuar dhimbjet e për të rehabilituar të mbijetuarit nga tortura. Në përputhje me nevojat për një punë të përbashkët midis qendrave të Tiranës, Prishtinës, dhe departamentit përkatës në Tetovë, kemi menduar që të koordinojmë punën në mënyrë që të ndihmojmë këtë departament të ngrihet në nivelin e një qendre dhe kësisoj të mund të krijojmë një lidhje koordinuese të bashkëpunimit midis tyre. Ne e kemi emërtuar atë Network-u Rajonal Mbarëshqiptar i Qendrave për Rehabilitimin e të Mbijetuarve nga Tortura. Ndoshta ky emërtim nuk është shumë i goditur dhe nuk i përgjigjet si duhet pikësynimeve tona, por mendoj se nuk është kjo gjëja më kryesore. Ne dëshirojmë të ecim përpara dhe të zhvillohemi nga pikëpamja institucionale, duke rritur kapacitetet në funksion të realizimit sa më të mirë të misionit tonë fisnik.

Jemi të mendimit se e gjithë kjo punë që do të bëjmë së bashku në këtë workshop është në logjikën e punës sonë, përfshirë këtu edhe atë në kuadrin e Network-ut Ballkanik si dhe të veprimtarisë ndërkombëtare për të realizuar stabilitetin në gadishullin ballkanik.

Ne shpresojmë që në këtë punë do të kemi mirëkuptimin dhe ndihmën e të gjithë miqve dhe kolegëve tanë, në veçanti të atyre të rrjeteve të Qendrave të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës. Gjithashtu, duam të përshëndesim Z. Nufri Lekaj nga Kosova, një nga ideatorët e këtij bashkëpunimi.

Shprehim mirënjohjen tonë të veçantë për veprën e Znj. Berit Backer në shërbim të kulturës shqiptare dhe në ndihmë të ish të përndjekurve politikë.

Në emër të Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të të Mbijetuarve të Torturës, ju falenderoj edhe njëherë për pjesmarrjen tuaj dhe shpallim të hapur këtë workshop dhe i uroj atij punime të mbara!

‘

Në vijim, një faksimile/dokument nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit, që dëshmon se Grupi për Kosovën i Komitetit Norvegjez të Helsinkit nga viti 1990 arriti të ketë edhe status zyrtar në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i riemëruar si Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH), me përgjegjësin e Grupit, Nufri Lekën, dhe koordinatoren e Grupit, Berit Backerin. Njëherësh kjo faksimile/dokument dëshmon se edhe projekti Aksioni Norvegji - Shqipëri (ANSh) kishte status zyrtar si pjesë integrale e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, me përgjegjësen e këtij projekti, Berit Backerin, dhe koordinatorin e këtij projekti, Nufri Lekën:

Den Norske Helsingforskomité

The Norwegian Helsinki Committee
Member of the International Helsinki Federation for Human Rights

Oslo, January 2000

TO WHOM IT MAY CONCERN

Mr. Nufri Lekaj worked with the Norwegian Helsinki Committee in the period from 1990 to 1994, as a project-coordinator, establishing the so-called Action Norway-Albania, together with Ms. Berit Backer. In their work they succeeded in establishing a rehabilitation-center for victims of torture in Tirana, made a survey of living-standard among former political prisoners, organized humanitarian assistance, and established human rights education. The human rights education project later developed into the Albanian Human Rights Education Center in Tirana.

Mr. Nufri Lekaj was for a period responsible for the Balkan-group within the Norwegian Helsinki Committee, which established the basis for the later human rights engagement of the Committee in the Balkan area. During the period Mr. Nufri Lekaj worked for the Committee, he traveled extensively within the Balkan area, including up to 4 months every year in Albania.

In 1994 did Mr. Nufri Lekaj leave his position within the Committee to start studies at the Norwegian School of Journalism.

We strongly appreciate the work Mr. Nufri Lekaj did within the Norwegian Helsinki Committee. The work of Mr. Nufri Lekaj was always done according to the highest standards and he showed a remarkable high quality of understanding concerning the Balkan situation.

Mr. Bjørn Engesland
Secretary-General
Norwegian Helsinki Committee

Den Norske Helsingforskomite
Urtegt. 50
N-0187 OSLO

Berit Backer ka qenë studiuese e kulturës shqiptare që nga vitet ’70 dhe njohëse e spikatur (nga të huajt) e gjendjes shoqëroro-politike në Kosovë dhe Shqipëri, njëherësh veprimtare e shquar për kyçjen e çështjes shqiptare në kuadër të Procesit të Helsinkit. Pasi u bë pjesë (në cilësinë e këshilltares dhe bashkëpunëtores) e LPK-së në vitin 1987, u bë aktiviste e pakompromis për të drejtat e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, duke vënë tërë potencialin e vet në këtë drejtim, dhe duke bashkëpunuar ngushtë me Nufri Lekën, Ibrahim Kelmendin, Xhavit Halitin, Adem Demaçin etj. Përveçse e ndihmoi LPK-në, e ndihmoi në këtë vazhdë edhe LDK-në, madje ishte e pranishme në cilësinë e observatores inkurajuese gjatë themelimit të LDK-së, më tutje edhe kryeorganizatore e vizitës së parë zyrtare të Ibrahim Rugovës në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14-18 shkurt 1990. Me fjalë të tjera, idealistja dhe mikja e madhe e shqiptarëve, socio-antropologia norvegjeze Berit Backer, ka dhënë kontribut të pakrahasueshëm “nga të huajt” për Kosovën gjatë viteve ’80 dhe në fillimvitet ’90. Gjatë një periudhe historike kur Kosovës i mungonte përkrahja e “të huajve”, sidomos kur Kosova kishte më së shumti nevojë që zërat e ekspertëve “të huaj dhe të pavarur” t’i informojnë, veçanërisht t’i bindnin kancelaritë politiko-diplomatike të shteteve perëndimore për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, ka pasur njohje me personalitete të rëndësishme të jetës shoqëroro-politike kudo në botë, veçanërisht në Angli. Përveç të tjerëve, njohje ka pasur edhe me ish-ambasadorin e ShBA-së në Beograd, Warren Zimmermann, i cili ishte personalitet me ndikim të madh në kuadër të Procesit të Helsinkit ngaqë paraprakisht (1986-1989) kishte udhëhequr delegacionin e ShBA-së në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE). Përveç njohjes me personalitetet shqiptare në kuadër të emigracionit politik shqiptar, që nga veteranët si Ihsan Toptani, Anton Logoreci etj., në kuadër të punës kërkimore social-antropologjike në Kosovë, është njohur edhe me Ukshin Hotin, Idriz Ajetin, Fehmi Aganin, Mark Krasniqin etj. Gjatë viteve ’70 ka banuar për një kohë në familjen e Kuklecëve të Isniqit dhe gjatë kësaj kohe është marrë me një studim shkencor social-antropologjik për shqiptarët. E ka vizituar Shqipërinë disa herë edhe para viteve ’90 derisa i është ndaluar hyrja në Shqipëri nga regjimi i Enver Hoxhës dhe, pas përmbysjes së diktaturës në Shqipëri, i ka vazhduar vizitat e rregullta në Shqipëri.

Nuk u ndal kurrë duke ndihmuar Kosovën dhe Shqipërinë (që i donte aq shumë), derisa vdiq tragjikisht në vitin 1993, përkatësisht u vra nga një shqiptar i sëmurë psikik (sipas lajmit zyrtar), pjesërisht viktimë e një gjendjeje të rëndë mendore që u pa si mjet i përshtatshëm për t’u manipuluar dhe përdorur në mënyrë të sofistikuar nga UDB-a, e cila paraprakisht ia kishte ndaluar hyrjen Berit Backerit në Jugosllavi dhe, njëkohësisht, përpiqej të ndikonte me propagandë të sofistikuar në mesin e shqiptarëve që ta portretizonte Beritin si spiune dhe antishqiptare. Kjo vrasje ishte një goditje dhe tronditje tepër e madhe për bashkëpunëtorët e Beritës në Norvegji dhe jashtë Norvegjisë, dhe për të gjithë ata që e njohën nga afër dhe ishin të vetëdijshëm për rolin e saj shumë të rëndësishëm (përfshirë tekstshkruesin e këtij punimi), dhe për të gjithë ata shqiptarë që më shumë dhe më pak ishin në dijeni për rolin e saj të rëndësishëm në vitet ’80 dhe fillimvitet ’90. Me fjalë të tjera, kjo vrasje ishte tepër e rëndë ngaqë, përveçse ishte vrasje në kundërshtim me traditën shqiptare (vrasje e një femre), e humbëm një mike idealiste shumë të zellshme dhe të rëndësishme për Kosovën dhe Shqipërinë. Për më tepër, vrasja e saj ishte një tentim-atentat mbi çështjen shqiptare në opinionin evropian, në kuptimin se propaganda e UDB-së në mënyrë të sofistikuar përpiqej ta përdorë vrasjen e saj tek opinioni i huaj se kështu shqiptarët i “shpërblejnë” miqtë e tyre. Edhe pse kjo vrasje mizore pashmangshëm barti me vete pasoja për keqësimin e imazhit të shqiptarëve, megjithëkëtë pati rëndësi që shqiptarët menjëherë pas kësaj vrasje mizore, ditën të reagojnë siç u ka hije, duke marrë pjesë masivisht në varrimin e Berit Backerit, sidomos pjesëtarët e mërgatës shqiptare në Norvegji. E në mesin e shumë bashkëpunëtoreve të Beritit në Norvegji dhe jashtë Norvegjisë që ishin të

pranishëm në varrimin e saj (dhe një pjesë të tyre që dërguan telegrame ngushëllimi), të pranishëm ishin edhe bashkëpunëtorët e saj të ngushtë nga Kosova, Adem Demaçi dhe Gazmend Pula, duke përfshirë praninë e Ibrahim Kelmendit në cilësinë e përfaqësuesit të LPK-së. I pranishëm ishte edhe ambasadori i Shqipërisë në Suedi, B. Kokalari. Ndërsa presidenti Sali Berisha dërgoi telegram ngushëllimi, ndërsa presidenti Rugova kërkoi, nëpërmes Komitetit Norvegjez të Helsinkit, që të bëhet një deklaratë në emrin e tij në mediet norvegjeze në mënyrë që t'i shprehë keqardhjen e tij publikisht popullit norvegjez.

Në vijim një vlerësim për Berit Backerin nga studiuesi britanik i shqiptarëve, Harry Hodgkinson, përkatësisht një fragment nga hyrja në librin e Berit Backerit, shkruar nga Ann Christine Eek, duke iu referuar letrës së Harry Hodgkinson dërguar Beritës në vitin 1987

The British expert on the Albanians, Harry Hodgkinson, showed Berit his great respect in a letter written to her in 1987:

"It was a pleasure to meet you at Doreen and Anton Logoreci's, and a great privilege to be able to profit from your immense stock of knowledge and compassionate understanding of the Kosovars. I very much fear that we all took advantage of your kindness, and must have exhausted you by our questions and speculations. It was forbearing of you to undertake that impromptu seminar with such goodwill and kindness... When next you visit your friends in Manor House, perhaps we might arrange a luncheon party round the corner here with Anton and Doreen and Ishan Toptani..."

Ref:

Letter from Harry Hodgkinson, London, 22 April 1987. Anton Logoreci was an Albanian in exile who wrote "The Albanians: Europe's forgotten survivors", London 1977. Ishan Toptani was another of the leading Albanians in exile in London. Quoted with permisson from Bejtullah Destani, London.

Në vijim, një fragment nga shkrimi në gazetën serbe, politika ekspres, e muajit shkurt 1990, ku përveç tjerash atakohet Berit Backer, ngase sipas kësaj gazete Berit Backer mbështet dhe mban lidhjen në mes nga njëra anë veprimtaria e procesit të Helsinkit dhe nga ana tjetër grupeve të mbledhura rreth Adem Demaçit (i cili ende në këtë kohë ishte në burg) dhe grupeve të mbledhura rreth Ibrahim Rugovës etj. Pas këtij shkrimi të gazetës serbe, politika ekspres, Berit Backer shpallet person i padëshiruar «Non grata» për Jugosllavinë:



на и са групом професора који су годинама предавали на Универзитету у Приштини, као што су Скендер Ћиљо, Џерџ Минга, Пеломб Битри и други. Иначе, за рад ове групе директно је заинтересован албански краљ у избеглиштву Лека први.

Трећа група је група Идриза Ајетија, председника Одбора за заштиту људских права и слобода на Косову, која је повезана са групом косовских интелектуалаца као што су академик Марк Краснићи, академик Фехми Агани, др Јусуф Барјактари, надахнути радом покојног академика Алија Хадрија, чији син др Фљамур Хадри, као и академик Дервиш Рожаја, такође припадају групи. Сигурими се укључује и у рад ове групе, која, на другој страни, хвата везу са групом парламентараца из Хелсинкија, чији је представник био др Берит Беацкер из Осла.

Амбасадор Албаније у Бечу непосредно прати у раду све три ове косовске „алтернативне групе" – тврди наш добро обавештени саговорник.

Према писању „Света", у овом галиматијасу личности је и др Тефик Тефику из Тетова, директор агенције „Форист-милт" за коју се више нико и не пита да ли је страна агенција или агентура.

svet

Politika ekspres 27.02.90.

Në vijim një vlerësim për Berit Backerin nga ambasadori i Suedisë në Jugosllavi e Shqipëri, në periudhën e viteve 1987-1992, Jan Af Sillen, i botuar në gazetën norvegjeze "Aftenposten" në mars të vitit 1993, me rastin e vdekjes tragjike të Beritës (dhe i përkthyer një vijim në gjuhën shqipe):



Aftenposten Torsdag 18. mars 1993

Berit Backer

Det är med djup bestörtning som jag och min fru mottar budet om att Berit Backer mördats av en kosovoalbanan.

Ingen i Norden har förmodligen gjort mer än Berit Backer för att sätta sig in och förklara albanernas situation. Hon var en mycket kompetent forskare om det albanska folket och en välinformerad och objektiv iakttagare av situationen på Balkan, särskilt i Albanien och Kosovo.

Jag har träffat henne åtskilliga gånger under de senaste åren i framförallt Albanien, och ofta kunnat dra nytta av hennes djupa insikter om det politiska och ekonomiska läget där. Jag har ibland också haft tillfälle att läsa hennes intressanta analyser.

För mig, min fru och andra kolleger som kom i kontakt med henne, var hon en härlig människa — modig, kunnig, öppen och vänlig.

Med Berit Backers bortgång har de nordiska staterna förlorat en forskare och observatör om den albanska situationen som vi inte kan ersätta utan vidare.

Hon gick bort i en tid när hennes kunskaper behövdes mer än någonsin.

Våra tankar går till dem som stod Berit Backer nära och de många albaner i Albanien och Kosovo som nu måste upprörda över illdådet och sörja en nära vän och insiktsfull hjälpare.

JAN AF SILLÉN
Sveriges ambassadör i Jugoslavien och Albanien 1987—92.

Gazeta norvegjeze "Aftenposten", mars 1993

Berit Backer

Me pikëllim të thellë unë dhe zonja ime morëm lajmin për vrasjen e Berit Backerit nga një shqiptar i Kosovës. Askush në shtetet nordike nuk ka bërë më shumë se Berit Backeri për ta njohur dhe sqaruar situatën e shqiptarëve. Ajo ishte një shkencëtare shumë kompetente për popullin shqiptar dhe vrojtuese e mirinformuar dhe objektive e situatës në Ballkan, posaçërisht në Shqipëri dhe Kosovë. Unë e kam takuar shumë herë këto vitet e fundit në rrugën e saj për në Shqipëri dhe shpesh kam pasur mundësinë të përfitoj nga njohuritë e saj të thella për gjendjen politike dhe ekonomike atje. Gjithashtu, nganjëherë më ka rastisur t'i lexoj edhe analizat interesante të saj.

Për mua, zonjën time dhe kolegët e tjerë të cilët ishim në kontakt me të, ajo ishte një person i mrekullueshëm, e guximshme, e shkathtë, e hapur, miqësore. Me vdekjen e Berit Backerit shtetet nordike kanë humbur një observatore të situatës së shqiptarëve të cilën nuk ka kush ta zëvendësojë. Ajo iku kur më shumë se kurrë nevojiteshin njohuritë e saj.

Mendimet tona shkojnë te të gjithë ata të cilët ishin të afërt me Berit Backerin dhe te shumë shqiptarë në Shqipëri dhe Kosovë të cilët i ka prekur vdekja e saj tragjike dhe i ka kapluar zija për humbjen e një mike dhe përkrahëse të pashoqe.

JAN AF SILLÉN, ambasador i Suedisë në Jugosllavi e Shqipëri, 1987-1992.

Në foto: Adem Demaçi, Gazmend Pula, Shkëlzen Kukleci, Nufri Lekaj, Qani Dehari, Musa Ramadani duke bartur arkivolin e Berit Backerit.

Në vijim një fragment (i përkthyer në vijim në shqip) nga hyrja në librin e Berit Backerit, shkruar nga Ann Christine Eek, duke cituar pjesë nga letra ngushëlluese e Drejtoreshës/përfaqësueses së Federatës Ndërkombëtare të Helsinikit, Yadja Zeltman, në lidhje me vdekjen tragjike të Berit Backerit :

Who was this Northern friend of the Albanians who, at least in Kosova, became a virtual legend of her time? After the death of Berit Backer, letters of condolence were received from many different people and organisations. The representative for The International Helsinki Federation, Yadja Zeltman, wrote of her: "Her unrelenting work and dedication to the cause of the Albanian communities fostered greater understanding for the needs of those communities, especially those in Kosova, and the need for a greater involvement of the international community in the defence of their basic human rights.[1]" That Berit Backer was the friend of all Albanians was confirmed in many ways, as shown by these words from Macedonia: "Her death is such a loss for the cause of Human Rights that we feel we have lost one of the great crusaders for humanity.[2]"

---

[1] Letter of condolence to the Norwegian Helsinki Committee, dated 9 March 1993.

[2] Letter of condolence to the Norwegian Helsinki Committee, from the president of the Democratic Forum for Human Rights in Gostivar: Milaim Pejsi, 9 March 1993.

"...Përfaqësuesja (drejtoresha) e Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, Yadja Zeltman, ka shkruar (për Berit Backerin): "Puna dhe përkushtimi i saj i paepur për shqiptarët inkurajoi për një kuptueshmëri më të madhe për nevojat e domosdoshme të shqiptarëve, veçanërisht në Kosovë, dhe nevojën për një përfshirje më të madhe të bashkësisë ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të tyre themelore të njeriut"....."

Në vijim një artikull i gazetës norvegjeze "Dagbladet", në mars të vitit 1993, në lidhje me vrasjen tragjike të Berit Backerit (i përkthyer në vijim në gjuhën shqipe):

Kosovos president beklager drapet

– Jeg kan ikke forstå at en person med albansk blod i årene kan drepe et menneske som Berit Backer, sa den kosovoalbanske presidenten Ibrahim Rugova til Nufri Lekaj i går ettermiddag. Rugova ringte selv og sa, han var sjokkert over drapet, sier Lekaj.

Berit Backer var en av de viktigste ambassadørene i Vesten for både Albania og de to millioner albanerne i Kosovo.

Hun var nær venn både av den albanske presidenten Sali Berigha, og av presidenten for den provisoriske regjeringen i Kosovo, Ibrahim Rugova.

Også den albanske forfatteren Ismail Kadare, som i mange år har vært en av de fremste favorittene til Nobels litteraturpris, var blant hennes venner.

I bøker, radioprogrammer og avisartikler har Berit Backer i snart 20 år vært en av de viktigste informatorer om forholdene i Albania og det tidligere Jugoslavia. Hun var en av meget få som har hatt kontakter i det som før var den politiske opposisjonen. Og hadde derfor meget gode kontakter med dagens ledere.

Berit Backer snakket både albansk og serbokroatisk flytende.

Dagbladet mars 93

Gazeta norvegjeze "Dagbladet", mars '93

Presidenti i Kosovës shpreh keqardhje për vrasjen

Nuk mund ta kuptoj se një person me gjak shqiptari në deje të vrasë një person si Berit Backer, i tha presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, Nufri Lekajt dje pasdite. Rugova e mori në telefon dhe i tha se është i shokuar nga lajmi i vrasjes, thotë Lekaj.

Berit Backeri ishte ambasadorja më e spikatur në Perëndim si për Shqipërinë ashtu edhe për dy milionë shqiptarë në Kosovë. Ajo ishte mike e afërt e presidentit të Shqipërisë, Sali Berisha, po ashtu edhe e presidentit të Qeverisë Provizore të Kosovës, Ibrahim Rugova.

Ismail Kadare, shkrimtar shqiptar i cili është me vite një ndër kandidatët kryesor për Çmimin Nobel për Letërsi, ishte një ndër miqtë e saj.

Berit Backeri për më shumë se 20 vjet ishte informatorja kryesore për gjendjen në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi nëpërmes librave, radioprogrameve, artikujve në gazeta etj. Ajo ishte një nga shumë pak persona që ka pasur kontakte me ata të cilët më herët ishin opozitë, prandaj edhe kishte kontakte shumë të mira me liderët aktualë. Berit Backeri fliste rrjedhshëm shqipen dhe serbokroatishten.

Në vijim lajmërimi i LPK-së me rastin e vdekjes tragjike të Berit Backerit:

LAJMËRIM

Me keqardhje të madhe e morëm lajmin mbi vrasjen e Berit Backerit, aktiviste e shquar për të drejtat e njeriut pranë Komitetit të Helsinkit dhe mikesh e popullit shqiptar.

Barit Backer ishte një ndër figurat e shquara norvegjeze e cila e kuptoi drejt çështjen shqiptare dhe u angazhua me forcë për internacionalizimin e saj. Atëherë kur më së tepërmi populli ynë kishte nevojë për miq, ishte Berit Backeri e cila iu gjend popullit tonë për parashtrimin real të gjendjes në Kosovë. Pikërisht për këtë, vrasja e Berit Backerit përveçse është një akt kriminal, njëherit është edhe një atentat mbi çështjen shqiptare në opinionin evropian!

Armiqtë e kombit tonë, ata që na mbajnë të pushtuar dhe veglat e tyre, do të propagandojnë te opinioni i huaj se kështu i «shpërblejnë» shqiptarët miqët e tyre, ata që i dalin krah popullit shqiptar! Ne e dijmë se kjo nuk është e vërtetë. Populli shqiptar i ka nderuar dhe respektuar në mënyrë të veçantë miqtë që e kanë ndihmuar atë.

Por ja si ndodhi! Një shqiptar (sipas informatave të pavërtetuara deri më tash - i sëmurë psikik) vrau një veprimtare të shquar për çështjen tonë kombëtare! A u bë kjo nga marrëzia, nga interesat e ngushta egoiste apo të shtyrë nga pushtuesit, në fund të fundit, kjo pak çon peshë. Fatkeqësia është aty se dyfish u dëmtua çështja jonë: ***së pari***, humbëm një përkrahëse të zellshme të çështjes sonë dhe një mikeshë të mirë që zor e kemi ta gjejmë një tjetër si ajo, dhe ***së dyti***, kjo ka lënë përshtypje aq të keqe te opinioni i huaj dhe veçanërisht te opinioni norvegjez, i ka indinjuar ata pa masë, sa çështja jonë në këtë opinion do të pritet me akullsi!

Ditën e mërkurë, më 17 mars 1993, në ora 11.00 do të bëhet varrimi i së ndjeres Berit Backer në Oslo. Shkuarje për t'i bërë homazhin e fundit Berit Backerit për shqitparët kudoqofshin dhe në mënyrë të veçantë për shqiptarët në Skandinavi është një ***OBLIGIM MORAL***. Masoviteti ynë sa më i madh është mirënjohja jonë më e thellë për Berit Backerin si mikesh e popullit tonë dhe kështu, njëherit, do të diferencoheshim dhe do ta dënonim aktin kriminal dhe vetë kriminelin shqiptar para opinionit norvegjez!

PJESËMARRJA NË VARRIMIN E BERIT BACKERIT ËSHTË NJË KONTRIBUT I MADH PËR TË TREGUAR RESPEKTIN E POPULLIT TONË NDAJ SË NDJERËS!

- Lavdi Jetës dhe Veprës së Berit Backerit!

- I përjetshëm qoftë kujtimi për Të!

Lëvizja Popullore e Republikës së Kosovës

Telegramet e ngushëllimit Komitetit të Helsinkit në Oslo mund t'i drejtohen në këtë telefaks: (0047) 22 - 57 00 88 (në Oslo).
Komittit të Helsinkit mund t'i drejtoheni edhe gojarisht (në shqip) përmes telefonit (0047) - 22 - 57 00 70.

Në vijim një shkrim i Milaim Zekës ku, përveç të tjerash, shkruan për vizitën e parë zyrtare të Ibrahim Rugovës në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14-18 shkurt 1990, dhe në lidhje me vdekjen tragjike të Berit Backerit në vitin 1993. Përndryshe, Milaim Zeka, gjatë një periudhe, kur ishte shpërngulur nga Suedia në Norvegji, ka bashkëpunuar me Nufri Lekën dhe Berit Backerin në lidhje me përpilimin e një raporti për situatën e shqiptarëve në Jugosllavi, dhe në lidhje me një prej demonstratave të organizuara nga Këshilli i LPK-së në Oslo, në të cilën demonstratë Milaim Zeka u është drejtuar gazetarëve norvegjezë në lidhje me kërkesat e demonstruesve shqiptarë. Raporti që përpiluan u botua me emrin "Straff og Politikk i Kosova" (Politika dhe dënimet në Kosovë), dhe mund të thuhet se ky raport u bë një bazë për kuptimin e situatës në Kosovë dhe si një pikë referimi i ministrive të jashtme në shtetet nordike. Milaim Zeka, edhe pse nuk ka qenë pjesë e LPK-së - GBKNH-s, kjo nuk ka qenë pengesë për këtë bashkëpunim me të. Dhe pas qëndrimit në Oslo për disa kohë, Milaim Zeka është kthyer në Suedi, ku edhe ka jetuar dhe vepruar për një kohë të gjatë. Gjatë qëndrimit të Milaim Zekës në Norvegji u iniciua edhe themelimi i Degës së LDK-së në Norvegji, të cilën degë e udhëhoqi për shumë vjet afaristi Fatmir Zymberi, i cili e pati në vazhdimësi një bashkëpunim të duhur me Nufri Lekën.

tesë

EKSKLUZIVE NR. 7/2000

Jetëshkrim i shkurtër i Dr. Berit Backer-it

Backer dhe Demaçi para Komitetit të Helsinkit (1992)

Dr. Berit Backer u lind në vitin 1947 në qytetin Mandal të Norvegjisë. Ajo kreu studimet në degën Sociologji Antropologji në Universitetin e Bergenit. Studimet e larta universitare i mbaroi në Universitetin e Osllos. Temën për diplomim, magjistrim, specializim dhe doktoranturë e kishte nga kultura shqiptare dhe titullohej: «STRUKTURA E FAMILJES SHQIPTARE». Për ta realizuar këtë temë shkoi në Kosovë dhe gjatë viteve 1974-1976 qëndroi në familjet shqiptare në fshatin Isniq dhe në rrethinën e tij të pasur me lëndë burimore konkrete për interesimin e saj. Antropologia Berit ishte përqëndruar me banim dhe studim në familjen e madhe të Kuklecëve. Aty gjeti dhe studjoi me kujdes të madh strukturën e trashëguar nëpër shekuj të jetës së familjes shqiptare. Ajo u mahnit me format e jetës, punës, qëndrimit dhe raporteve të familjeve të mëdha shqiptare, struktura e së cilave ishte një eveniment i jashtëzakonshëm. Prandaj studimi i saj bëri një jehonë të fuqishme në Universitetin e Osllos. Mjerisht ai studim dhe vlerat e tij ende nuk njihen nga opinionin lexues, madje as nga opinion studiues shqiptar, ashtu siç nuk njihet as edhe Raporti mbi gjendjen e të burgosurve politikë që kjo studiuese e bëri në vitin 1987.

Dr. Berit Backer, kështu u bë e vetmja specialiste në shtetet skandinave që aq mirë e kishte sudjuar dhe e njihte mirë Kosovën. Veçanërisht pas vitit 1990, ajo u bë një ambasadore e vërtetë e Kosovës. Në këtë vit, me bashkëpunëtorët shqiptarë, për herë të parë mundi të sjellë një delegacion të nivelit të lartë nga Kosova në krye me dr. Ibrahim Rugovën që shoqërohej nga Nufri Leka dhe Shkëlzen Maliqi. Ata u pranuan nga tre ministra norvegjezë dhe personalitete të tjera të larta parlamentare dhe kulturore të Norvegjisë. Më vonë, delegacionet që vinin nga Kosova i kishin dyert e hapura në të gjitha rangjet e këtij shteti.

Dr. Berit Backer ftohej, konsultohej dhe i kërkoheshin raporte dhe relacione nga organet qeveritare të Norvegjisë si Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë për Emigracion dhe asociacionet e ndryshme humanitare e profesionale si Amnesty International, Federata e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut etj., sepse ishte kompetente profesioniste për çështjen e Kosovës.

Jeta e atropologes së shquar Dr. Berit Backer u shua në mënyrë mizore, më 7 mars 1993. Ajo u vra me armë të ftohtë nga një vrasës shqiptar me emrin Malë Lajçi, i cili studionte në Suedi. Atëherë u fol shumë për mundësinë e motivimit politik të vrasjes, si një atentat politik, nxitur nga UDB-ja mbi miken e madhe të shqiptarëve, dr. Berit Backer-in. Gjyqi norvegjez konstatoi se krimineli shqiptar ka vrarë Berit Backerin për motive të ulëta! Vallë a është kjo e vërteta!?

Vrasësi gjendet ende në burg. Ndërsa shqiptarët, Kosova humbi, një ndër përkrahësit konkrete më të spikatura në Evropë, në luftën për liri dhe pavarësi nga Serbia.

SHKRUAR NGA MILAIM ZEKA

Maj 2018. Disa nga miqtë dhe bashkëpunëtorët mbledhur me rastin e përvjetorit e 25-të të Berites. Në foto, ulur nga e djathta në të majtë: Adem Demaçi, Ali Aliu, Zekë Sinanaj. Në këmbë nga e djathta: Xhelali (shoqëruesi i Adem Demaçit), Nufri Lekaj, Ann Christine Eek, Fatmir Zymberaj, Gazmend Pula, Shkëlzen Maliqi dhe Shkëlzen Kukleci.

Në përfundim të kësaj kumtese vlen të theksohet se, pavarësisht prej përpjekjeve të Grupit për Ballkanin në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit (GBKNH-s), si sektor lobist dhe i diplomacisë joformale i LPK-së dhe në përgjithësi përpjekjeve të LPK-së, gjithashtu përpjekjeve të Komitetit të Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Gjenevë, që rezultoi nga strukturat e LPK-së (dhe që pati njëlloj bashkëpunimi edhe me GBKNH-n), por edhe përpjekjeve të Klubit Kombëtar "Jusuf Gërvalla" në Nju-Jork, duke përfshirë përpjekjet e disa strukturave të tjera lobiste dhe të diplomacisë joformale të ish-emigracionit politik shqiptar (po ashtu të themeluara para shembjes së murit të Berlinit), që nga Organizata Rinia Shqiptare-Kosovare në Botën e Lirë, në Nju-Jork, Besëlidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare, Komiteti i Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Belgjikë, Shoqata "Migjeni" në Slloveni, Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane dhe, për më tepër, duke i përfshirë përpjekjet (pas shembjes së murit të Berlinit), të Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Prishtinë, të Komitetit të Helsinkit në Kosovë, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës në Ekzil, të degëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës në

Diasporë, të Komitetit të Kosovës në Paris, të Këshillit Shqiptaro - Amerikan etj. dhe, veçanërisht, pavarësisht prej përpjekjeve me ndikim të veçantë të presidentit me përgjegjësi të madhe politike dhe misionarit vizionar të paqes, Ibrahim Rugovës, nuk u arrit që nëpërmes këtyre përpjekjeve (që, në fakt, e ndërkombëtarizuan deri në maksimum çështjen e Kosovës) të imponohet çështja e Kosovës për zgjidhje në kuadër të Konferencës së Dejtonit. Megjithatë, të gjitha këto përpjekje nuk shkuan huq, por e patën ndikimin e vet, që t'i japin legjitimitet ndërkombëtar luftës së mëvonshme të UÇK-së, në kuptimin se shqiptarët e Kosovës, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, kishin provuar me vite ta zgjidhin problemin e Kosovës pa luftë, por ishin refuzuar nga Millosheviqi dhe se shtetet perëndimore nuk mund të toleronin të ndodhte në Kosovë e njëjta përmasë gjenocidiale që kishte ndodhur në Bosnjë, veçanërisht duke e marrë parasysh edhe faktorin gjeopolitik ngaqë një konflikt i armatosur në Kosovë (për dallim të Bosnjës) e kishte potencialin e zgjerimit të luftës përtej kufijve të Jugosllavisë. Në të gjithë këtë gamë të zhvillimit të ngjarjeve, përveç të tjerëve, tre LPK-istët që më herët e kishin bashkëthemeluar dhe mbështetur veprimtarinë e GBKNH-s (së bashku me Berit Backerin etj.), në këtë vazhdë gjatë periudhës së luftës në Kosovë, së bashku me ekipin e UÇK-së për marrëdhënie me jashtë (në përbërje nga Jashar Salihu, Ramadan Avdiu, Sabri Kicmari, Agush Buja, Bilall Sherifi, Rexhë Ibërdemaj, Xhevat Bislimi, Dino Asanaj, Mujë Rugova, Pleurat Sejdiu etj., në krye me Bardhyl Mahmutin, dhe kryetarin e LPK-së, Bedri Islami), kanë dhënë një kontribut pothuajse vendimtar për orientimin e duhur dhe faktorizimin politiko-diplomatik të luftës së lavdishme të UÇK-së si mjet i fundit për imponimin e çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare dhe si katalizator për çlirimin e Kosovës, në krye me prijësin emblematik ushtarak të UÇK-së, Adem Jasharin etj., dhe prijësin emblematik politik të UÇK-së, Adem Demaçin etj.

Biografi e shkurtër e Nufri Lekaj – Muriqit

Nufri Lekaj - Muriqi, rrjedh nga një familje e fshatit Koshutan të Rugovës e vëllazërisë Muriqi, përkatësisht pasardhëse e Gjekë Prenit (i njohur edhe si Gjekë Stanishi - Rugovalia), i cili la pas vetes katër djem të vëllazërisë Muriqi (Dedën, Lekën, Lucën dhe Palin), me të cilët kishte organizuar edhe rezistencën e parë në Rugovë kundër Perandorisë Osmane. [1] Si pasardhës i Lekë - Gjekës, Nufriu e mban me krenari mbiemrin Lekaj. Babai i Nufriut, Rexhepi, ka qenë pjesëmarrës i Lëvizjes Kaçake të Rugovës kundër ripushtimit të Kosovës nga Serbia e, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, për t'iu shmangur burgosjes, arratiset në krahinën e Plavë - Gucisë, ku i kishte dajat (pasardhësit e Alush Smajlit të Hotit) dhe, gjithashtu, nipat, (në fshatin Hakaj të Plavë - Gucisë). [2] Në këtë vazhdë, martohet me Hasnije Feratajn e bija e Ramë Ferataj, i cili së bashku me bashkëfamiljaret e tij, An Ferataj, Medi Ferataj etj., u vranë, plagosen dhe persekutuan për shkak të angazhimit të tyre në kuadër të rezistencës vetëmbrojtëse të popullatës shqiptare të Plavë - Gucisë në vitet 1912 - 1913. [3]. Pasi u lind Nufriu, Rexhepi vendos të kthehet me familje në Rugovë, dhe më pastaj shpërngulet në Pejë.

Që nga viti 1978 Nufriu (në shkollën e mesme në Pejë) fillon të solidarizohet dhe ta mbështesë veprimtarinë e Lëvizjes klandestine revolucionare të Kosovës. Në këtë vazhdë burgoset nga regjimi jugosllav në fillimvitet '80. [4] Pas lirimit nga burgu dhe pas ngritjes së aktakuzës së dytë ndaj tij për burgosje nga regjimi jugosllav, arratiset nga Kosova dhe, me sugjerim të shokëve të organizuar, emigron në Norvegji, ku kishte nevojë për organizim të emigracionit shqiptar në këtë shtet dhe në përgjithësi në Skandinavi. Kështututje, nga viti 1987 ka qenë një ndër drejtuesit në emigracion i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK-s) [5], dhe përgjegjës i Grupit për Ballkanin në Komitetin Norvegjez të Helsinkit (GBKNH), si sektor lobist dhe i diplomacisë joformale për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, që si Grup arriti të ndikojë jashtëzakonisht shumë për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në vitet '80 dhe fillimvitet '90 jo vetëm nëpërmes ndikimit në kuadër të institucioneve politike të shtetit norvegjez, por, gjithashtu, dhe veçanërisht, nëpërmes ndikimit në kuadër të Procesit të Helsinkit, përkatësisht Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (FNH-s), Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE-s) etj., njëherësh, vlen të theksohet se GBKNH, në kuadër të veprimtarisë së vet, organizoi edhe vizitën e parë zyrtare të misionarit vizionar të paqes, Ibrahim Rugovës, në Perëndim, përkatësisht në Oslo, me nisje nga Oslo më 14 - 18 shkurt 1990. [6] Njëkohësisht, në cilësinë e përgjegjësit të GBKNH-s (në kuadër të Komitetit Norvegjez të Helsinkit si organizatë pothuajse gjysmështetërore dhe këshillëdhënëse për Ministrinë e Jashtme Norvegjeze) ka shërbyer edhe si këshilltar i Ministrisë së Jashtme norvegjeze për çështjen e Ballkanit. Ka qenë i angazhuar me punë edhe në institucione të tjera shtetërore norvegjeze, përveç të tjerash, në Drejtorinë e Emigracionit dhe në radiotelevizionin shtetëror norvegjez. Në kuadër të veprimtarisë së GBKNH-s, edhe më pastaj, ka pasur bashkëpunim të ngushtë me simbolin e rezistencës kombëtare, Adem Demaçin etj. Pas sinjalizimit për mos-përfshirje të çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të Konferencës së Dejtonit, Nufriu e intensifikon bashkëpunimin e tij si pjesë e bashkëpunëtorëve të afërt të Sektorit të Veçantë të LPK-së, që në vitin 1994 u transformua në Shtabin Qendror të UÇK-së. Në këtë vazhdë përveç shprehjes së indinjatës nëpërmes organizimit të demonstratave, prononcimit në media etj., për mos-përfshirjen e çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të Konferencës së Dejtonit, me zhvillimin e ngjarjeve bëri një deklaratë publike (më 09.12.1997) për radiotelevizionin shtetëror norvegjez në përkrahje të UÇK-së, me qëllimin për ta imponuar mendimin në kuadër të diskursit mediatik ndërkombëtar, se UÇK-ja ekziston si mjet i fundit për imponimin e çështjes së Kosovës për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare dhe si katalizator për çlirimin e Kosovës dhe, gjithashtu, për t'i inkurajuar

bashkëkombësit shqiptarë në diasporë për rëndësinë e përkrahjes së UÇK-s. Kjo deklaratë e parë në diasporë dhënë një medieje shtetërore të huaj, në mbështetje të UÇK-së, u emitua në mediet skandinave dhe më gjerë. [7] Me këtë rast, për shkak të kësaj deklarate, i komunikohet lajmi nga punëdhënësi norvegjez se nuk mund të vazhdojë të punojë në institucione shtetërore norvegjeze. Megjithëkëtë, në fundvitin 1997, e inicioi me bashkëpunëtor konsolidimin e Bashkësisë Shqiptare në Norvegji (BSHN), njëherësh e ushtroi detyrën e zëdhënësit të BSHN-së, që si rast unik në diasporën shqiptare, arriti të unifikojë/përfshijë brenda vetes të gjitha subjektet politike dhe kulturore shqiptare në Norvegji, pa dallim bindjesh politike dhe fetare, me një qëllim: në përkrahje logjistike, politike dhe diplomatike të UÇK-së. [8] Kështututje (gjatë periudhës së luftës në Kosovë) e mori përgjegjësinë dhe detyrën e përfaqësuesit politik të UÇK-së për Skandinavinë, i emëruar nga përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi. [9] Në periudhën e viteve 1999-2000 Nufriu ka qenë përfaqësues diplomatik i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në Norvegji. Dhe nga viti 2000 deri në vitin 2008 (përkatësisht deri me njohjen formale më 28.03.2008 të pavarësisë së Kosovës nga shteti norvegjez), ka qenë kryetar i Zyrës së Kosovës në Norvegji. Pas njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Norvegjia dhe shtetet e tjera skandinave, Nufriu deklaron se Zyra e Kosovës në Norvegji mbyllet, sepse e ka përfunduar misionin e vet si veprimtari pro-njohjes së Republikës së Kosovës nga Norvegjia dhe nga shtetet e tjera skandinave. Megjithëkëtë, për të mos i ikur ndonjë përgjegjësie për Kosovën, i njofton institucionet përkatëse politike në Kosovë se, po qe se kanë nevojë, është në dispozicion të kryejë çfarëdo shërbimi diplomatik për Kosovën, pa pagesë. [10] Në këtë vazhdë nuk ka hezituar ta ofrojë ndihmën e tij të formës këshilluese dhe për çfarëdo tjetër që iu ka drejtuar ndokush nga institucionet politike të Kosovës.

Sa i përket shkollimit të lartë, Nufriu ka studiuar në Kosovë për elektroteknikë në Universitetin e Prishtinës, ndërsa në Norvegji ka studiuar për sociologji në Universitetin e Oslos dhe për gazetari në shkollën e lartë të gazetarisë në Oslo, njëherësh ka zhvilluar edhe përvojë hulumtuese si bashkautor i raporteve hulumtuese, të shkruar enkas për ministritë norvegjeze. [11] Në ndërkohë, nga fundvitet ’80, është angazhuar edhe si përkthyes i autorizuar në Norvegji. Ndërsa për veprimtarinë e tij është mirënjohur, përveç të tjerash: në shtator të vitit 1991, me propozim të Komitetit Norvegjez të Helsinkit, është ftuar, së bashku me bashkëveprimtarin e tij, Ole Drolsum, në darkën solemne (në Kështjellën e Oslos) të organizuar nga ish-kryeministrja e Norvegjisë, Gro Harlem Brundtland, ku ishin të ftuar (pjesëmarrës) edhe një numër i konsiderueshëm i ekspertëve ndërkombëtarë, si shenjë mirënjohje për të pranishmit për kontributin e tyre për të drejtat e njeriut në nivel botëror. Pas propozimit të Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë në Norvegji (me arsyetimin se ka pasur rol të rëndësishëm për krijimin e opinioneve për dhjetëvjeçarin e fundit) në vitin 2001 i jepet mirënjohje nga Organizata Ndërkombëtare Who’s Who për Profesionalistët për vitin 2000. [12] Në vitin 2015 është shpallur veteran i UÇK-së (njësitë vartëse të Shtabit të Përgjithshëm). Është edhe bashkëiniciator në vitin 2021 për formimin e Këshillit Shqiptar në Norvegji (KShN), si platformë e bashkëpunimit dhe faktorizimit të organizatave shqiptare në Norvegji dhe vazhdimit të traditës së bashkëpunimit të duhur në kuadër të mërgatës shqiptare në Norvegji. Kjo iniciativë u formalizua me themelimin e KShN-s më 18.03.2023. Tri vendbanimet me adresat e regjistruara të Nufriut, janë shtëpia në Koshutan në Rugovë (Kosovë), banesa në Tiranë (Shqipëri), dhe shtëpia në Oslo në Norvegji. Është i martuar me Eltona Cenon dhe i kanë tre fëmijë tashmë të rritur, Gencin, Erën dhe Pirron.

Referencat:

[1]Fazli Sh. Muriqi - Alias Bajraktari (2018): Osman - Lekajt e Koshutanit (Monografi). Shtypshkronja Dukagjini, Pejë., f. 18 – 22, 115 – 122

[2]Po aty 110 – 114

[3]Zekeria Cana (1996): Gjenocidi i Malit të Zi, mbi popullin shqiptar 1912-1913 (Dokumente). Prishtinë, 1996, f. 174 - 177

[4]https://www.scribd.com/document/557546433/Politika-Nordike-dhe-Levizja-Popullore-e-Kosoves-LPK , f. 61 - 62

[5]Po aty: 62 - 65, 109 - 121, 261 – 267

[6]Po aty: 68 – 71, 126 – 127, 132 – 150 – 165, 171 – 195, 196 - 202

[7]Deklaratë në mbështetje të UÇK-së, dhënë për radiotelevizionin shtetëror norvegjez (më 09. 12. 1997) dhe e emituar në mediet skandinave dhe më gjerë, duke përfshirë mediat shqiptare: në Gazetën "Bujku" (10.12.1997), në Qendrën për Informimin e Kosovës -QIK (10. 12. 1997), në Gazetën Rilindja (11.12.1997) e titulluar: "Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së".

[8]https://www.scribd.com/document/557546433/Politika-Nordike-dhe-Levizja-Popullore-e-Kosoves-LPK , f. 86 - 88

[9]Po aty: 91

[10]Po aty: 97, 99 – 102, 106, 215 – 221, 224 – 225

[11]Po aty: 66-67, 73, 122-125

[12]Po aty 61, 68, 75, 102, 109 – 112, 81, 126 – 127